



TË DIPLOMUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL 2021-2022

GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:


swisscontact

**TË DIPLOMUARIT NGA
ARSIMI PROFESIONAL**

2021-2022

GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR



Tetor 2023



TË DIPLOMUARIT NGA ARSIMI PROFESIONAL 2021-2022: GJURMIMI NË NIVEL KOMBËTAR

Tetor 2023

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
Projekti Aftësi për Punë

Ky publikim është realizuar nga projekti “Aftësi për Punë” (S4J), nën mbikëqyrjen e Menaxherit të Projektit, Fation Dragoshi. Raporti u përgatit nga Ledia Thomo PhD, konsulente dhe Assoc. Prof. Ines Nurja, konsulente për metodologjinë.

Rreth projektit “Aftësi për Punë”

“Aftësi për Punë” (S4J), është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact.

Shënim: Pikëpamjet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim, nuk paraqesin domosdoshmërisht ato të Qeverisë Zvicerane ose Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

TABELA E PËRMBAJTJES

PERMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
1. HYRJE	13
2. METODOLOGJIA	15
Qasja metodologjike	15
Instrumenti i studimit - pyetësoni	15
Analizimi i të dhënave	17
Kufizimet metodologjike	18
3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË	19
4. REZULTATET	21
4.1 SITUATA E PUNËSIMIT E TË DIPLOMUARVE	22
Situata aktuale e punësimit	22
4.2 TË DIPLOMUARIT E PUNËSUAR	27
Tranzicioni drejt tregut të punës – koha e gjetjes së punës së parë	27
Tranzicioni drejt tregut të punës – mënyra e gjetjes së punës së parë	31
Integrimi në tregun e punës – karakteristikat kryesore në punën aktuale	33
Integrimi në tregun e punës – të ardhurat	38
Integrimi në tregun e punës – përputhshmëria e arsimit	40
4.3 TË DIPLOMUARIT QË PO VAZHDOJNË KUALIFIKIME TË MËTEJSHME	45
Institucioni arsimor në të cilin vazhdojnë studimet të diplomuarit	45
Lidhja mes fushës së studimeve me studimet e mëparshme	46
Ansyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimeve	47
4.4 TË DIPLOMUARIT PA PUNË	48
Të kërkuarit për punë	49
Marrëdhënia me zyrat e punës	52
Të diplomuarit e papunë në kërkim të një pune, që kanë qenë të punësuar më parë	55
4.5 VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË DIPLOMUARVE PËR SHKOLLËN	56
5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	63





PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjurmimi në nivel kombëtar realizohet për herë të tretë nga AKPA me mbështetjen e Projektit Aftësi për Punë (S4J). Tre gjurmimet kanë anketuar të diplomuarit, përkatësisht në vitet 2020, 2021 dhe 2022 në shkollat publike të arsimit profesional që operojnë në të gjithë vendin. Këto gjurmime kanë pasur si qëllim kryesor monitorimin e treguesve më të rëndësishëm të tregut të punës me të cilët përballen të diplomuarit nga sistemi i arsimit profesional. Të dhënat janë analizuar në nivel kombëtar dhe në nivel rajonal (Rajoni Verior, Qendror, Juglindor dhe Jugperëndimor).

Këto studime synojnë të përshkruajnë sesi të diplomuarit janë integruar në tregun e punës dhe përbëjnë një mjet të rëndësishëm për të vlerësuar situatën e shkollave profesionale në Shqipëri dhe masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e rolit të tyre në përgatitjen e nxënësve për t'u integruar me sukses në tregun e punës.

Studimi i fundit, i zhvilluar në muajt maj-qershor 2023, i referohet të diplomuarve të vitit 2022. Duke qënë se është studimi i tretë i kësaj natyre, mundëson edhe paraqitjen e dinamikës së ecurisë së shkollave profesionale në synimin e tyre final të përmirësimit dhe përshtatjes më të mirë me tregun e punës.

Në këtë studim, numri i të diplomuarve të vitit 2022 që i janë përgjigjur plotësisht pyetësorit në anketimin e bërë në 2023, një vit pas diplomimit, është 1248 nga 3427 të diplomuar, ose 36.4% e tyre. Gjetjet kryesore të paraqitura në vijim, janë krahasuar edhe me treguesit e viteve të mëparshme.

- Rreth 60% nga të diplomuarit në vitin 2022, ishin në marrëdhënie pune në vitin në vijim. Ndër ta, 40% ishin të punësuar, 7% ishin të vetë-punësuar ndërsa 13% punonin dhe studionin në të njëjtën kohë. Krahasuar me një vit më parë, ka një rritje të lehtë të punësimit, në nivelin 3 pikë përqindje.
- Numri i të vetë-punësuarve nga të diplomuarit e vitit 2022 është ulur në 6.7% nga 8% që shënonte për të diplomuarit e një viti më parë, ndërsa është rritur grupi i të diplomuarve që punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë (13% nga 11.2%).
- Është rritur përqindja e të diplomuarve të kohortës 2022, që janë në kërkim aktiv të një pune (10.3% nga 7.7% një vit më parë), ndërsa është ulur përqindja e të dekurajuarve (7.1% nga 10.8% një vit më parë), ndonëse është ruajtur përqindja e njëjtë e të diplomuarve që nuk janë në marrëdhënie pune, gjë që tregon se potencialisht më shumë të diplomuar janë bërë aktivë në tregun e punës.
- Meshkujt e kohortës 2022 kanë pësuar rritje të punësimit të tyre në vitin pas diplomimit në krahasim me një vit më parë, (64.1% kundrejt 59.8%), duke shfaqur ndërkohë ulje të përqindjes së atyre që ndjekin studime të mëtejshme (18.6% nga 20.9%). Vajzat shfaqin ulje të punësimit në vitin pas diplomimit në krahasim me një vit më parë (38.9% nga 46.1%) ndërsa shfaqin rritje të prirjes për të vazhduar studime të mëtejshme (43.4% nga 36.4%).
- Punësimi për të diplomuarit e vitit 2022, rritet në të gjitha rajonet me rreth 4 pikë përqindje në krahasim në vit më parë, me përjashtim të Rajonit Qendror (60.7%), ku punësimi ruan pothuaj të njëjtin nivel. Në ndryshim nga studimi i mëparshëm, ku punësimi shfaqej më i lartë në Rajonin Qendror dhe Jugperëndimor, për kohortën 2022, është Rajoni Perëndimor që shfaq përqindjen më të lartë të të punësuarve ndër të katër rajonet (63.4%).
- Drejtimi ku të diplomuarit e vitit 2022 kanë punësimin më të lartë, ashtu si dhe një vit më parë, është Hoteleri-Turizëm (70.7%). TIK ka pësuar uljen me të

madhe në punësimin e të diplomuarve në 2022 krahasuar me një vit më parë (afërsisht 10 pikë përqindje), por ka në të njëjtën kohë edhe përqindjen më të lartë të të diplomuarve që kanë zgjedhur të vijnë studime të mëtejshme (40.9%). Ndërsa drejtimi që ka pasur rritjen më të madhe të punësimit ndër të diplomuarit e vitit 2022, është Elektronika me 67.6% të punësuar në 2023, nga 55.4% një vit më parë.

- Më shumë se gjysma e të diplomuarve të vitit 2022 që aktualisht janë në marrëdhënie pune, deklarojnë se janë punësuar që para diplomimit, përqindje kjo që ruhet nga një vit më parë. Rritja më e ndjeshme e të diplomuarve në marrëdhënie pune që janë punësuar para diplomimit në krahasim me një vit më parë shfaqet në Rajonin Verior (me 20 pikë përqindje) dhe në Rajonin Jugperëndimor (me 7.1 pikë përqindje).
- Ndër të diplomuarit e kohortës 2022, që janë intervistuar në vitin 2023, ulet ndjeshëm mënyra e gjetjes së punës me anë të njohjeve dhe lidhjeve familjare në krahasim me një vit më parë (64.3% nga 81.5%), duke rritur peshën e kanaleve të tjera të përdorura për këtë qëllim. Rritja më e ndjeshme, i përket gjetjes së punës bazuar në praktikat profesionale në biznes (11.9% nga 4.1% një vit më parë). Rritja e përqindjes së të diplomuarve që preferojnë këtë kategori të gjetjes së punës shprehet më dukshëm në Rajonet Juglindore dhe Jugperëndimore (18.0% dhe 19.4% nga 3.0% dhe 3.3% përkatësisht).
- 34.1% e të vetëpunësuarve nga kohorta e vitit 2022, kanë të punësuar më shumë se tre persona në punën aktuale, nga 19.6% të vetëpunësuar prej kohortës së vitit 2021. Kjo tendencë rritjeje mund të jetë gjithashtu një tregues se bizneset po orientohen drejt sipërmarrjeve më të mëdha, me më shumë punonjës.
- Nga të diplomuarit e vitit 2022, më shumë të punësuar me page (12.3%), punojnë në ndërmarrje të mëdha në momentin e intervistimit, nga kohorta e një viti më parë kur përqindja ishte 4.1%. E njëjta tendencë, por pak më e zbutur vihet re edhe lidhur me ndërmarrjet e mesme dhe të vogla (të diplomuarit që punojnë në to rriten me 4 pikë përqindje), ndërsa ulet ndjeshëm përqindja e të punësuarve në ndërmarrjet mikro (42,2% nga 58.9%).
- Më shumë se 80% e të diplomuarve të anketuar, që janë në marrëdhënie pune, ndihen të sigurt apo shumë të sigurt në punën e tyre aktuale, ndërsa një vit më parë, më pak se 40% mund të pohonin një gjë të tillë. Rritja e ndenjes së sigurisë, paraqitet më e ndjeshme në të diplomuarit e drejtimit Ekonomi-Biznes (92.2% nga 39.6% një vit më parë) si dhe Hoteleri-Turizëm (88.5% nga 30.4% një vit më parë).
- Më shumë se një e treta e të diplomuarve të punësuar nga kohorta e vitit 2022, ashtu si dhe një vit më parë, kishin të ardhura nga puna në intervalin 40.001-50.000 lekë. Më pak të punësuar kanë paga nën këtë nivel në punën aktuale (17%) ndërsa është rritur me rreth 10 pikë përqindje pesha e të punësuarve me paga në fashat 50.001-95.000 lekë. Ndonëse në përqindje të vogla, rritje në krahasim me një vit më parë, kanë pësuar edhe pagat e fashës mbi 95.000 lekë (7.4% nga 3.5%).
- Hendeku gjinor në paga është i pranishëm edhe në punësimin e të diplomuarve të kohortës 2022, me më shumë femra që paguhen deri në 50.000 lekë (60%), ndërkohë që 60% e meshkujve përqëndrohet më shumë në nivelet e pagave 50.001-95.000 lekë.

- Të diplomuarit e vitit 2022, të punësuar në drejtimet Ekonomi-Biznes dhe Elektroteknikë punojnë me paga të larta (më shumë se një e treta e tyre paguhet në intervalin 60.001-90.000 lekë). TIK dhe SHMT kanë më shumë të diplomuar që punojnë me paga të intervalit 50.001-60.000 lekë (rreth një e katërta e tyre) ndërsa drejtimi Hoteleri-Turizëm, ka më shumë punonjës me pagë në fashën 40.001-50.000 lekë (35%).
- Rritet relevanca e profileve të studimit në arsimin profesional, me 63.4% të punësuar nga të diplomuarit e kohortës 2022, që pohojnë se fusha e studimit të tyre është e lidhur me punën që kryejnë. Një vit më parë kjo përqindje ishte 50%. Hoteleri-Turizëm është drejtimi në të cilin shfaqen më shumë të diplomuar të punësuar që pohojnë relevancën e studimeve me punën që kryejnë (82.3%) ndërsa drejtimet Ekonomi-Biznes dhe TIK shfaqin përqindjen më të ulët (28.3% dhe 45.2% respektivisht).
- Më shumë se gjysma e të diplomuarve të vitit 2022 që janë të punësuar, pohon se është duke i përdorur shumë ose jashtëzakonisht shumë njohuritë e fituara gjatë studimeve në punën aktuale, me një rritje të ndjeshme nga viti i mëparshëm (52.3% nga 46.0%). Përqindjet më të larta të të diplomuarve me këtë pohim janë në Rajonin Juglindor dhe Qendror.
- Rritet në mënyrë drastike perceptimi i të diplomuarve të punësuar (nga kohorta e vitit 2022), lidhur me ndihmesën e shkollës për të kërkuar punë; vetëm 1% deklaroi se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar kundrejt 52.2% një vit më parë. Kategoritë që shprehin rritje në krahasim me një vit më parë janë sidomos vendosja e kontakteve me punëdhënës potencialë (18.3% nga 6.8%), orientimi mbi mundësitë e ndryshme të punësimit (26.9% nga 15.2%), dhe me një rritje prej 10 herë më shumë, ndihmesa nëpërmjet orientimit për t'u regjistruar te Zyrat e Punës (34.7% nga 3.3%).
- Shumica e të diplomuarve të vitit 2022, që i vazhdojnë studimet përtej shkollës profesionale një vit më pas, priren të zgjedhin një universitet (95.5%) dhe më pak priren të ndjekin një formim profesional (4.5%). Kjo tendencë është më e theksuar në Rajonin Qendror (97.4%) dhe e ngjashme me një vit më parë.
- Më shumë femra se meshkuj vazhdojnë studimet universitare nga kohorta e vitit 2022 (97.7% kundrejt 94.6%), me një tendencë të kundërt ndaj një viti më parë kur përkundrazi, ishin meshkujt që prireshin më shumë në këtë drejtim. Në të kundërt, më shumë meshkuj se femra priren të vazhdojnë një formim profesional në krahasim me femrat (5.1% ndaj 1.5% respektivisht).
- Rreth 74% e të diplomuarve të vitit 2022, që vijojnë studimet pas arsimit profesional, deklarojnë se fusha e tyre e studimeve lidhet me studimet e mëparshme, sidomos në Rajonin Verior dhe Qendror (rreth 80%). Përqindja e të diplomuarve me këtë pohim ka një rënie të lehtë nga një vit më parë, impaktuar më së shumti nga një rënie drastike në Rajonin Jugperëndimor (62.0% nga 88.3%).
- Më shumë se një e treta e të diplomuarve nga viti 2022 që janë të papunë, po e kërkojnë një punë në momentin e anketimit (34.7%), me një përqindje më të madhe në Rajonin Juglindor (43.1%) dhe më pak të diplomuar të papunë aktivë në Rajonin Jugperëndimor (28.1%).
- Për të diplomuarit e vitit 2022, ulet në mënyrë të ndjeshme mënyra tradicionale e kërkimit të punës nëpërmjet njohjeve dhe lidhjeve familjare (50% nga 80% një

vit më parë). Bën dallim sidomos rritja e preferencës së kërkimit për punë nëpërmjet Zyrave të Punës (35.7% nga 10%).

- Më shumë se një e treta e të diplomuarve të papunë që nuk kërkojnë punë (37.3%) shfaqin si arsye planet për t'u larguar nga vendi. Megjithatë kjo përqindje është më e ulët krahasuar me një vit më parë (47%), ka një ndryshim të rëndësishëm nën këndvështrimin gjinor me femrat që arrijnë të njëjtat nivele me meshkujt, duke mos synuar punësimin për shkak të planeve për të migruar (rreth 40% për të dy gjinitë kundrejt 51.9% të meshkujve dhe 16% të femrave një vit më parë).
- Më shumë të diplomuar nga kohorta e vitit 2022, do të zgjidhnin të njëjtën shkollë nëse do të kishin mundësi (rreth 83% në vitin 2023 ndaj 75.4% në 2022). Rreth 83% të të diplomuarve pohojnë se do të zgjidhnin sërish të njëjtin drejtim, me nivele të ngjashme për të dyja gjinitë.
- Të diplomuarit e vitit 2022, vlerësojnë me 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës, metodat e mësimdhënies dhe infrastrukturën me përkatësisht 86.4%, 83.7% dhe 82.5% përkatësisht. Aspektet e vlerësuara më ulët me 'pak ose aspak' nga kohorta e të diplomuarve, në vitin 2022, janë bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës (21.5%) ndjekur nga këshillimi i karrierës (14.8%) dhe bashkëpunimi i shkollës me bizneset (13.2%).
- Pritshmëria e të diplomuarve të vitit 2022 për të gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit në dy vitet e ardhshme, dyfishohet në krahasim me një vit më parë (31.4% nga 16.6%), ndërkohë që një e katërta e të diplomuarve synonte të vijonte studimet (21.3% nga 10.1% një vit më parë). Për të dyja këto kategori, janë femrat që dominojnë me pritshmëritë e tyre kundrejt meshkujve. Nga ana tjetër, ulët kategoria e të diplomuarve të kohortës 2022, që synojnë të emigrojnë jashtë vendit krahasuar me vitin paraardhës (23.1% krahasuar me 12.5% një vit më parë).

Lista e tabelave

Tabela 1. Parashikimi i optimizimit në 4 rajone sipas shkollave	18
Tabela 2. Shpërndarja sipas gjinisë, 2022	19
Tabela 3. Shpërndarja sipas drejtimeve mësimore, 2022	20
Tabela 4. Shpërndarja sipas rajoneve, 2022	20
Tabela 5. Statusi i punësimit sipas gjinisë, 2020-2022	24
Tabela 6. Situata aktuale e punësimit sipas rajoneve, 2022	24
Tabela 7. Situata aktuale e punësimit sipas rajoneve, 2021	25
Tabela 8. Statusi i punësimit sipas grupeve (%Po), 2022	27
Tabela 9. Puna e parë pas mbarimit të shkollës (si % e të diplomuarve që janë të punësuar) sipas rajoneve, 2020-2022	28
Tabela 10. Puna e parë pas mbarimit të shkollës (% e të diplomuarve që janë të punësuar) sipas gjinisë, 2022	29
Tabela 11. Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit sipas rajoneve, 2022	30
Tabela 12. Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit sipas gjinisë, 2022	30
Tabela 13. Të punësuar në biznes sipas rajoneve, 2022	31
Tabela 14. Mënyra e gjetjes së punës të parë sipas rajoneve, 2022	31
Tabela 15. Gjetja e punës së parë sipas gjinisë, 2021-2022	32
Tabela 16. Numri i punonjësve në kompaninë ku të diplomuarit punojnë sipas rajoneve, 2022	33
Tabela 17. Lloji i kontratës së punës sipas rajoneve, 2022	34
Tabela 18. Lloji i kontratës së punës sipas rajoneve, 2021	34
Tabela 19. Perceptimi i siguri (stabilitet) në punën aktuale sipas rajoneve, 2022	35
Tabela 20. Perceptimi i siguri (stabilitet) në punën aktuale sipas rajoneve, 2021	35
Tabela 21. Perceptimi i siguri (stabilitet) në punën aktuale sipas gjinisë, 2022	35
Tabela 22. Perceptimi i siguri (stabilitet) në punën aktuale sipas gjinisë, 2021	36
Tabela 23. Perspektiva e vetë-punësimit sipas rajoneve, 2022	37
Tabela 24. Perspektiva e vetë-punësimit sipas rajoneve, 2021	37
Tabela 25. Relevanca e punës me fushën e studimit sipas rajoneve, 2020-2022	41
Tabela 26. Relevanca e fushës së aktivitetit të vetë-punësimit me studimet, 2020-2022	41
Tabela 27. Shkalla e përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve në punën aktuale sipas rajoneve, 2020-2022	43
Tabela 28. Shkalla e relevancës së pozicionit aktual me studimet sipas rajoneve, 2020-2022	44

Tabela 29. Ndhurma nga shkolla për të gjetur punë sipas rajoneve, 2021-2022	45
Tabela 30. Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimit sipas rajoneve, 2022	47
Tabela 31. Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimit sipas rajoneve, 2021	47
Tabela 32. Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimit sipas gjinisë, 2021-2022	48
Tabela 33. Mënyra e të kërkuarit për punë sipas rajoneve, 2022	49
Tabela 34. Mënyra e të kërkuarit për punë sipas rajoneve, 2021	49
Tabela 35. Mënyra e të kërkuarit për punë sipas gjinisë, 2021-2022	50
Tabela 36. Arsyetja e të mos kërkuarit për punë sipas rajoneve, 2022	51
Tabela 37. Arsyetja e të mos kërkuarit për punë sipas gjinisë, 2022	51
Tabela 38. Arsyetja e të mos kërkuarit për punë sipas gjinisë, 2021	52
Tabela 39. Arsyetja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas rajoneve, 2022	53
Tabela 40. Arsyetja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas rajoneve, 2021	53
Tabela 41. Aspektet që janë vlerësuar 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas rajoneve, 2022	58
Tabela 42. Aspektet që janë vlerësuar 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas rajoneve, 2021	58
Tabela 43. Aspektet që janë vlerësuar 'pak dhe aspak' në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas rajoneve, 2022	59
Tabela 44. Aspektet që janë vlerësuar 'pak dhe aspak' në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas rajoneve, 2021	59
Tabela 45. Aspektet që janë vlerësuar 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas gjinisë, 2022	60
Tabela 46. Aspektet që janë vlerësuar 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas gjinisë, 2021	60
Tabela 47. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas rajoneve, 2022	61
Tabela 48. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas rajoneve, 2021	62

Lista e figurave

Figura 1. Situata aktuale e punësimit, 2020-2022	22
Figura 2. Situata aktuale e punësimit sipas gjinisë, 2020-2022	23
Figura 3. Statusi i punësimit sipas drejtimit, 2020 – 2022	26
Figura 4. % e të diplomuarve të punësuar që kanë gjetur punë deri në 3 muaj pas diplomimit sipas drejtimeve, 2022	29
Figura 5. Perceptimi i sigurisë (stabilitetit) në punën aktuale sipas drejtimit (shumë të sigurt ose të sigurt), 2021-2022	36
Figura 6. Perspektiva e vetë-punësimit sipas gjinisë, 2021-2022	38
Figura 10. Niveli i pagave sipas drejtimeve, 2022	40
Figura 11. Relevanca e fushës së aktivitetit të vetë-punësimit me studimet sipas gjinisë, (%Po), 2020-2022	42
Figura 12. Lidhja e punës me studimet sipas gjinisë, 2020-2022	42
Figura 13. Lidhja e punës me studimet sipas drejtimit, 2020-2022 (% Po)	43
Figura 14. Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas institucioneve arsimore dhe rajoneve, 2021-2022	45
Figura 15. Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas gjinisë, 2021-2022	46
Figura 17. Të diplomuar të papunë (në kërkim të një pune në 4 javët e fundit) sipas rajoneve (%Po), 2020-2022	48
Figura 18. Punëkërkues të papunë të regjistruar tek Zyra e Punës sipas rajoneve (%Jo), 2021-2022	52
Figura 19. Ansyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas gjinisë, 2021-2022	53
Figura 20. Ndihma e Zyrës së punës për të gjetur një punë, 2022	54
Figura 21. Ndihma e Zyrës së punës për të gjetur një punë sipas rajoneve, 2022	54
Figura 22. Ndihma e Zyrës së punës për të gjetur një punë sipas gjinisë, 2022	55
Figura 23. Të punësuar që nga koha e diplomimit/mbarimit të shkollës sipas rajoneve, 2021-2022	55
Figura 24. Zgjedhja e të njëjtës shkollë sipas gjinisë, 2020-2022	56
Figura 25. Zgjedhja e të njëjtës degë/drejtimit sipas gjinive (%Po), 2021-2022	56
Figura 26. Zgjedhja e të njëjtës degë/drejtimit sipas drejtimeve (%Po), 2021-2022	57
Figura 27. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme, 2021- 2022 (%)	61
Figura 28. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas gjinisë, 2022	62

1. HYRJE

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit apo të certifikuarit e një institucioni arsimor realizohet nëpërmjet ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen/certifikohen. Gjurmimi i të diplomuarve është një praktikë e konsoliduar dhe standarde në sektorin e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Evropë. Të dhënat nga studimet gjurmuese përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi relevancën e ofertës për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura (shiko për shembull Schomburg, 2016)¹.

Në Shqipëri, ndryshimet në vitet e fundit në kuadrin rregullator dhe të politikave kanë filluar të zëvendësojnë praktikën ad hoc të gjurmimit me praktika sistematike dhe standarde – si në nivel kombëtar dhe në nivel institucioni arsimor apo ofruesi. Në përputhje me ligjin nr.15/2017 ‘Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë’ dhe VKM nr. 554 datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive është institucionalizuar gjurmimi në nivel kombëtar me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) përgjegjëse për kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së. Ndërkohë, institucionet ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional (IoAFP) janë përgjegjëse nëpërmjet Njësive të zhvillimit për gjurmimin në nivel ofruesi.

Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të AFP në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve. Ato përfaqësojnë një nga burimet e rëndësishme për vlerësimin dhe mbështetjen në përmirësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së AFP me tregun e punës. Tematikat e gjurmimit janë të shumfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Në këtë kuadër, AKPA me mbështetjen e projektit Skills for Jobs (S4J) ndërmoni gjurmimin në nivel kombëtar të të diplomuarve të brezit 2020-2021 nga shkollat publike të arsimit profesional në 12 qarqet e Shqipërisë me qëllimin e përgjithshëm të monitorimit të treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit nga sistemi i AP.

Objektivat specifike të gjurmimit në nivel kombëtar mund të përmbledhen si më poshtë:

- Vlerësimi i statusit të përgjithshëm të punësimit të të diplomuarve nga AP;
- Vlerësimi i diferencave në statusin e punësimit sipas gjinisë, rajoneve, apo sektorit të ekonomisë;
- Identifikimi i treguesve specifike rreth integritit në tregun e punës për të diplomuarit, si koha mesatare në gjetjen e punës së parë, mënyrat e gjetjes së punës së parë, profili i punës etj.



¹ Marrë nga: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/carrying-out-tracer-studies-guide-anticipating-and-matching>

- Analizimi i të diplomuarve të punësuar në lidhje me tipare si relevanca e studimeve me vendin e punës, paga, kushtet e punës etj.
- Analizimi i të diplomuarve që zgjedhin të ndjekin kualifikime të mëtejshme pas diplomimit;
- Vlerësimi i institucioneve ofruese bazuar në perceptimin retrospektiv të të diplomuarve;
- Krijimi i një baze për studimet dhe analizat e mëtejshme gjurmuese në nivel kombëtar për të krijuar një standard në këtë drejtim.

1283 të diplomuar nga 34 shkolla të arsimit profesional iu përgjigjën sondazhit të gjurmimit gjatë periudhës maj-qershor 2023 ose 11-12 muaj pas diplomimit të tyre. Ky raport përshkruan dhe analizon të dhënat dhe rezultatet e përgjithshme mbi rrugëtimin profesional të të diplomuarve pas mbarimit të studimeve, integrimin e tyre në tregun e punës, si dhe aspekte të tjera që mund të ndihmojnë drejt vlerësimit të orientimit drejt tregut të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Rezultatet kryesore janë paraqitur në përputhje me objektivat e studimit të gjurmimit. Ndërkohë, analizohen edhe krahasime në kohë me brezin e mëparshëm të gjurmuar.

Raporti është strukturuar si më poshtë vijon. Seksioni në vijim përshkruan metodologjinë e ndjekur për gjurmimin kombëtar. Me tej analizohen në detaj rezultatet për a) kategorinë e të diplomuarve të punësuar, b) të diplomuarve që ndjekin kualifikime të mëtejshme, c) të diplomuarve pa punë, si dhe d) perceptimet mbi vlerësimin e institucioneve bazuar në vlerësimin retrospektiv të të diplomuarve. Në seksionin përmbyllës jepen rezultatet e përgjithshme dhe rekomandimet kryesore.

2. METODOLOGJIA

Qasja metodologjike

Për studimin e gjurmimit kombëtar të të diplomuarve nga shkollat e arsimit profesional u përdor një model hulumtimi tërthorë ku të dhënat u mbledhën nëpërmjet pyetësorëve të standardizuar përgjatë muajve maj-qershor 2023. Popullata e cila u studiua janë të diplomuarit në vitin 2022 nga shkollat publike të arsimit profesional.

Ky nuk është studimi i parë që kryhet për këtë grup të shënjestruar. Para vitit 2021, këto studime janë realizuar duke përdorur një kampion në bazë të numrit total të të diplomuarve. Në vitin 2021, duke marrë parasysh nevojat për të gjeneruar indikatorë të disagreguar në nivel: rajoni, grupi social, drejtimi mësimor etj. u realizua censusi i popullatës në vend të përzgjedhjes së një kampioni. Gjatë këtij procesi madhësia e popullatës së synuar ishte e vogël në numër – rreth 4101 nxënës të diplomuar nga 36 shkolla në vitin 2020. Në fund të anketimit informacioni i mbledhur mbuloi 1412 të diplomuar ose 34% të tyre. Pjesa më e madhe si pasojë e kontakteve të gabuara, ndërsa një pjesë tepër e vogël si pasojë e refuzimit.

Në vitin 2022 është kryer fillimisht një pilotim demografik për të kuptuar nivelin e përgjigjeve. Gjatë pilotimit demografik niveli i përgjigjeve ishte 39%. Në bazë të këtij rezultati u mor vendimi të kryhet përsëri një census në mënyrë që të merret një informacion i plotë dhe që çdo i diplomuar të ketë të njëjtën mundësi pjesëmarrjeje në studim dhe për të pasur të dhëna sa më të sakta statistikisht si në nivel kombëtar dhe atë rajonal. Niveli i përgjigjeve ishte 33.6% e të diplomuarve.

Duke pasur parasysh eksperiencën e dy viteve të kaluara këtë vit është kryer përsëri census për të diplomuarit në vitin 2022. Për kontaktin e të diplomuarve u përdor baza e të dhënave të disponueshme e siguruar nga AKPA. Popullata përfshinte 3427 nxënës që kishin mbaruar studimet gjatë vitit 2022. 36.4 % e të diplomuarve në vitin 2022 u anketuan 11-12 muaj pas diplomimit të tyre. Kjo periudhë mund të konsiderohet e mjaftueshme që të diplomuarit të jenë integruar në tregun e punës ose të jenë në kërkim aktiv të një pune.

Instrumenti i studimit - pyetësi

Të dhënat për studimin e gjurmimit u bazuan në një pyetësor të standardizuar të organizuar me blloqe kryesore pyetjesh ashtu si dhe gjatë dy viteve të fundit.

Duke pasur parasysh eksperiencën e viteve të kaluara, në pyetësor u bënë disa rishikime si në lidhje me përmbajtjen dhe me mënyrën e organizimit. Megjithatë është pasur parasysh që ndryshimet e bëra të ishin të tilla që të lejohej krahasimi me të dhënat e përfutuara më parë.

Duke u nisur nga fakti se qëllimi kryesor i anketimit ishte të studiohej përfshirja e nxënësve të diplomuar në tregun e punës, pyetja kryesore ishte statusi i tyre në momentin e anketimit.

Grupet në të cilat ndaheshin të anketuarit ishin:

- të punësuar (të punësuar, studentë që punonin dhe studionin në të njëjtën kohë)
- të vetë-punësuar
- të papunë aktivë
- joaktivë (studentë, shtëpiakë, të dekurajuar, PAK)

Secili nga grupet kishte bllokun e pyetjeve korrespondente sipas karakteristikave përkatëse.

Disa nga pyetjet për grupin e parë dhe të dytë (të diplomuarit në marrëdhënie pune) ishin:

- koha e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- mënyra e gjetjes së punës ose e hapjes së biznesit
- përputhja e drejtimit me vendin e punës
- intervali i pagës
- dobia e njohurive të marra në shkollë në vendin e punës
- siguria dhe kënaqshmëria me vendin e punës

Për grupin e tretë ose të papunët:

- perceptimi mbi statusin
- roli i zyrave të punës për të gjetur punë

Për grupin e fundit ose të diplomuarit ekonomikisht joaktivë rëndësi të veçantë kishin si të dekurajuarit, dhe ata që po ndiqnin kualifikime të mëtejshme. Për të dekurajuarit, qëllimi ishte të merrej informacion pse ata nuk e mendonin veten të aftë për të gjetur një punë, ndërsa për ata që po ndiqnin kualifikime të mëtejshme, lloji i kualifikimit, arsyeja e ndjekjes së studimeve, si dhe lidhja e tyre me drejtimin profesional.

Për të gjithë të anketuarit pavarësisht statusit të punësimit u drejtua një grup i njëjtë pyetjesh mbi:

- nevojën për përmirësime në aspekte të veçanta në shkollë
- perspektivën e tyre për të ardhmen profesionale.

Ashtu si dhe në anketimin e mëparshëm u përdorën intervistat telefonike, me anë të një teknike të njohur si CATI (Computer-assisted telephone interview) në të cilën intervistuesi telefonon të anketuarin dhe regjistron përgjigjet e tij në një aplikacion kompjuterik, i cili administrohet online nëpërmjet përdorimit të Platformës Kobo

Toolbox².


Për kryerjen e pyetësorit për të diplomuarit u angazhuan tre persona të cilët u trajnuan nga eksperti i metodologjisë për mënyrën e duhur të administrimit. Pyetësi zgjaste mesatarisht rreth 6 minuta.

Analizimi i të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave, u realizua pastrimi, tabulimi dhe analizimi i tyre duke përdorur programin statistikor SPSS. Tabulimi dhe analiza përfshijnë:

- përshkrimin deskriptiv të të dhënave nëpërmjet tabelave dhe grafikëve të ndryshëm.
- krahasimin me brezat e mëparshëm të gjurmuar.

Rezultatet janë prezantuar dhe analizuar në raport në agregat dhe sipas parashikimeve të ndarjes rajonale të optimizimit të ofruesve të AFP-së, që i ndajnë ofruesit në 4 rajone siç tregohet më poshtë.



■ ■

2 <https://www.kobotoolbox.org/>

Tabela 1. Parashikimi i optimizimit në 4 rajone sipas shkollave

Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jugperëndimor	Rajoni Juglindor
Hamdi Bushati	Beqir Cela	Industriale Pavarësia	Demin Progri
Arben Broci	Hysen Cela	Tregtare Vlorë	Shkolla e Ndërtimit Korçë
Kole Margjini	26 marsi	Antoni Athanas	Fan Noli
Ndre Mjeda	Shkolla e Mesme Kombëtare e Agrobiznesit Golem	Thoma Papapano	Isuf Gjata
Kolin Gjoka	Hoteleri-Turizëm Tiranë	Petro Sota	Irakli Terova
Nazmi Rushiti	Teknike-Ekonomike Tiranë	Rakip Kryeziu	Enver Qiraxhi
Havzi Nela	Gjengji Canco	Shkolla Mekanike Lushnjë	Kristo Isak
Industriale Rubik	Hermann Gmeiner		Stiliano Bandilli
	Karl Gega		Ali Myftiu
	Qendra Shumëfunksionale Kamëz		Salih Ceka
			Mihal Shahini

Kufizimet metodologjike

Bazuar në faktin që anketa duhej të ishte census të dhënat duhet të merrreshin për të tërë popullatën, por vetëm 36% e të diplomuarve në vitin 2022 arritën të intervistoheshin. Kjo shkallë më e ulët vjen kryesisht si pasojë e: kontakteve të paplota dhe të gabuara në disa raste në databazën e popullatës. Megjithatë, 36% e të diplomuarve ose 1248 është një numër me të cilin mund të kryen analiza të sakta dhe mund të nxirren përfundime pasi të dhënat janë përfaqësuese, si në nivel vendi dhe rajoni.

3. PËRSHKRIMI I DEMOGRAFISË

Gjurmimi kombëtar për të diplomuarit nga shkollat e arsimit profesional në vitin 2022, mblodhi informacione rreth 1248 të diplomuar nga të cilët, ashtu si dhe në studimet e mëparshme, shumicën e përbënin meshkujt. Përqindja më e ulët e vajzave ndër të anketuarit lidhet me peshën më të vogël që zë kjo gjini ndër të gjithë të diplomuarit meqënëse tradicionalisht drejtimi profesional ndiqet më shumë nga meshkujt. Tabela e mëposhtme, që paraqet shpërndarjen gjinore të të diplomuarve dhe të anketuarve, ilustron faktin se pesha e vajzave ndër të anketuarit (18.1%) është pothuajse në të njëjtin nivel me peshën e tyre ndër të diplomuarit gjithsej (18.7%). Në vijim, analiza e rezultateve do t'i referohet vetëm të diplomuarve të përgjigjur (1248 vetë).

Tabela 2. Shpërndarja sipas gjinisë, 2022

Gjinia	% të diplomuarit	Të anketuarit	% të anketuarit
Femër	18.7	226	18.1
Mashkull	81.3	1022	81.9
Total	100	1248	100

Ndër të dhënat demografike të të intervistuarve, mund të merret informacion edhe mbi përfshirjen e grupeve të veçanta në arsimin profesional. Në studimin aktual të gjurmimit, rezulton se 30 nga të 1248 të diplomuarit e anketuar apo 2.4% i përkisnin komunitetit Rom dhe Egjiptian, dhe shtatë të anketuar rezultuan individë me aftësi të kufizuar. Gjithashtu, bëhet e ditur se 17.3% e të diplomuarve vinin nga familje që përfitonin ndihmë ekonomike.

Shpërndarja e të diplomuarve sipas drejtimeve mësimore në vitin 2022, tregon se cilat janë drejtimet e ndjekura nga më shumë nxënës. Ashtu si dhe në vitin e kaluar, pesë drejtimet kryesore, të cilat janë ndjekur nga më shumë se 100 nxënës zënë një peshë prej 64% ndërmjet të diplomuarve (63.9% në 2021). Përqindja e të diplomuarve në pesë drejtimet kryesore është e ngjashme me peshën që zënë këto drejtime edhe në popullatën gjithsej të të diplomuarve (65.1%). Drejtimi më i ndjekur nga të diplomuarit e kohortës 2022, rezulton të jetë Hoteleri-Turizëm (19.2%). Drejtimi i Shërbimeve të Transportit renditet i dyti (ndjekur nga 16.4% të të diplomuarve). Ky drejtim zinte vendin e parë në kohortën e të diplomuarve të vitit 2021, dhe zëvendësimi i përparësisë që merr drejtimi Hoteleri-Turizëm ndër preferencat e nxënësve, mund të merret si një tregues që drejtimet mësimore të zgjedhura reflektojnë prioritetet ekonomike individuale, ekonomike dhe të tregut. Drejtimi Ekonomi-Biznes i ndjekur nga 11.2% e të diplomuarve të përgjigjur bën dallim me renditjen në vend të tretë duke superuar degët TIK (9.2%) dhe Elektroteknikë (8.4%) që shfaqeshin më të preferuara nga kohorta e vitit 2021.

Tabela 3. Shpërndarja sipas drejtimeve mësimore, 2022

Drejtimi	Të anketuarit	% e të anketuarve
Hoteleri - Tunizëm	239	19.2
Shërbime mjetesh transporti (SHMT)	205	16.4
Ekonomi-Biznes	140	11.2
Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)	115	9.2
Elektroteknikë	105	8.4
Mekanikë	75	6.0
Termohidraulik	74	5.9
Teknologji Ushqimore	63	5.0
Shërbime sociale dhe shëndetësore	44	3.5
Bujqësi	30	2.4
Inxhinieri Informatike Softvaresh	27	2.2
Rrjete të dhënash (Pilot- GIZ)	25	2.0
Veterinari	22	1.8
Tekstil-Konfeksion	21	1.7
Ndërtim	15	1.2
Shërbime kujdesi për të moshuar (Pilot - GIZ)	14	1.1
Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji	10	0.8
Përpunim Druri	9	0.7
Detari	6	0.5
Gjeodezi	6	0.5
Pyje	3	0.2
Total	1248	100

Ndër të diplomuarit e arsimit profesional vihet re një përqëndrim mjaft i lartë në Rajonin Qendror (58.7%). Pjesa tjetër e të diplomuarve është e shpërndarë në mënyrë të balancuar: 15% në Rajonin Juglindor, 14% në Rajonin Jugperëndimor, dhe 12.3% në Rajonin Verior.

Tabela 4. Shpërndarja sipas rajoneve, 2022

Rajonet	Të anketuarit	% e të anketuarve
Rajoni Verior	154	12.3
Rajoni Qendror	732	58.7
Rajoni Juglindor	187	15.0
Rajoni Jugperëndimor	175	14.0
Total	1248	100.0



4. REZULTATET

4.1 SITUATA E PUNËSIMIT E TË DIPLOMUARVE


Situata aktuale e punësimit

Të dhënat e gjurmimit japin një panoramë mjaft të rëndësishme të integrimit të të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, si dhe mbi shkallën e aktivizimit dhe arsyet e mospjesëmarrjes së tyre në tregun e punës. Gjithashtu, krahasimi në vite mundëson detaje mbi dinamikën e këtyre fenomeneve në harkun kohor 2020-2022. Bazuar në të dhënat e gjurmimit, pothuajse 60% të të diplomuarve në vitin 2022, ishin të punësuar pas një viti (40% të punësuar, 7% të vetëpunësuar dhe 13% që punojnë dhe studiojnë/trajnohen në të njëjtën kohë).

Trendi rritës i të punësuarve gjithsej (59.5%) pas diplomimit nga viti 2020, tregon për një rritje të të punësuarve në krahasim me fillimin e periudhës (40.2%), dhe më pas për një rritje graduale nga viti 2021 (57.5%). Ky fenomen sugjeron impaktin e përpjekjeve në funksion të forcimit të rolit të shkollave të arsimit profesional në përshtatje me tregun e punës, dhe qëndrueshmërinë në mbështjetjen e këtij roli në vijim. Ndërmjet kategorive, përveç rritjes së ndjeshme të të punësuarve me pagë, që përbën dhe shumicën e të punësuarve gjithsej, (40% në 2022, nga 38% në 2021 dhe 31% në 2020), edhe grupet e të vetëpunësuarve dhe të atyre që ndjekin studime krahas punës kanë pësuar rritje të ndjeshme duke u dyfishuar nga viti 2020 në vitin 2022, dhe duke vijuar me rritje më të vogël nga viti 2021, madje përsa i përket të vetëpunësuarve vihet re një ulje e lehtë në vitin 2022 (7%) krahasuar me vitin 2021 (8%).


Fenomeni më i dukshëm gjatë periudhës 2020-2022, është ulja drastike e të diplomuarve të papunë që kërkonin punë (10% në 2022, nga 23% në 2020), ndërsa ka një rritje të lehtë prej 2 pikë përqindjesh në vitin 2022 krahasuar me 2021 (8%). Të diplomuarit e papunë, por që nuk po e kërkonin një të tillë, kanë një trend luhatës duke përfunduar në të njëjtat nivele në vitin aktual (7% në 2020, 11% në 2021, dhe përsëri 7% në 2022), ndërsa dallim bën grupi i inaktivëve që janë studentë apo kursantë në trajnim të mëtejshëm, të cilët kanë rënie drastike nga viti 2020 (29%) në krahasim me dy vitet e fundit (24% në 2021, dhe 23% në 2022). Analiza e fenomenit sugjeron se, të diplomuarit në kohortat 2021 dhe 2022, priren të aktivizohen në tregun e punës më shumë se të vijnë në studime të mëtejshme.

Figura 1. Situata aktuale e punësimit, 2020-2022



Analiza e të dhënave me këndvështrim gjinor tregon një diferencë të madhe të përqindjes së të punësuarve meshkuj (64.1%) ndaj të punësuarve femra (38.9%), duke konfirmuar pohimin e përgjithshëm se, në Shqipëri, meshkujt janë më aktivë në tregun e punës. Në të tre vitet e studimit të gjurmimit, përqindja e të punësuarve meshkuj është dukshëm më e lartë se për femrat (Figura 4.1.2), por është pozitiv fakti që nivelet e shkallës së punësimit tregojnë një trend rritës për të dy gjinitë gjatë periudhës në studim. Të dyja gjinitë nisin periudhën 2020-2022 me nivele mjaft të ulëta të punësimit në krahasim me vitin e fundit, dhe ndonëse femrat shfaqin ulje në vitin 2022, në krahasim me një vit më parë, shkalla e punësimit të tyre është dyfish më e lartë sesa në vitin 2020.

Figura 2. Situata aktuale e punësimit sipas gjinisë, 2020-2022



Një vështrim më i hollësishëm ndër kategoritë e inaktivëve, pra që janë pa punë dhe nuk po e kërkojnë një të tillë, janë duke ndjekur studimet apo inaktivë të tjerë (Tabela 4.1.1), lë të kuptohet se ulja e shkallës së punësimit për femrat në vitin 2022, është e lidhur kryesisht me rritjen e vajzave që vendosin të ndjekin studime të mëtejshme. Si rrjedhim, ndërsa hendeku gjinor shënon ulje të konsiderueshme në vitin 2021 (14 pikë përqindje nga 25 pikë përqindje në vitin 2020), diferenca e punësimit të femrave dhe meshkujve vjen në të njëjtat nivele në vitin 2022 (26 pikë përqindje).

Të diplomuarit e papunë por që janë në kërkim aktiv të një pune, shfaqin gjithashtu dallime ndërmjet gjinive. Këto dallime ishin shumë më të forta në vitin 2020 (24.2% të meshkujve të diplomuar kundrejt 14% të femrave), ndërsa në dy vitet e fundit niveli dhe diferenca gjinore janë zbutur (7.5% për femrat dhe 10.9% për meshkujt në vitin 2022, nga 6.5% për femrat dhe 8.0% për meshkujt në vitin 2021).

Një vështrim më i hollësishëm ndër kategoritë e inaktivëve (Tabela 4.1.1), lë të kuptohet se ulja e shkallës së punësimit për femrat në vitin 2022, është e lidhur kryesisht me rritjen e vajzave që vendosin të ndjekin studime të mëtejshme. Si rrjedhim, ndërsa hendeku gjinor shënon ulje të konsiderueshme në vitin 2021 (14 pikë përqindje nga 25 pikë përqindje në vitin 2020), diferenca e punësimit të femrave dhe meshkujve vjen në të njëjtat nivele në vitin 2022 (26 pikë përqindje).

Referuar grupeve që përbëjnë inaktivët, grupi i të papunëve që nuk kërkojnë punë, ose të tjetër inaktivë, superohet gjerësisht nga studentët dhe kursantët që ndjekin shkollën apo trainime të mëtejshme për të dyja gjinitë. Meshkujt ruajnë nivele më të qëndrueshme, gati dy herë më të ulëta se femrat në ndjekjen e studimeve, duke qenë më aktivë në tregun e punës menjëherë sapo mbarojnë shkollën, ndërsa femrat preferojnë të vijojnë studimet gjë që sugjeron se arsyet mund të jenë: akses më i vështirë në tregun e punës, apo nevojë për të patur një kualifikim më të lartë për të gjetur një punë më të mirë.

Tabela 5. Statusi i punësimit sipas gjinisë, 2020-2022

Statusi i punësimit	2020		2021		2022	
	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër	Mashkull	Femër
I/E punësuar	33.7%	13.0%	40.4%	27.6%	43.9%	21.2%
I/E vetë-punësuar	5.0%	0.5%	9.1%	2.3%	7.7%	2.2%
Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	4.9%	4.7%	10.2%	16.1%	12.4%	15.5%
Pa punë dhe po kërkoj punë	24.2%	14.0%	8.0%	6.5%	10.9%	7.5%
Pa punë por nuk kërkoj punë	7.7%	3.6%	11.0%	10.1%	6.5%	9.7%
Student/Kursant	24.2%	58.0%	20.9%	36.4%	18.6%	43.4%
Tjetër inaktiv	0.3%	6.2%	0.4%	0.9%	0.0%	0.4%

Rajoni Jugperëndimor dhe Qendror shfaqin përqindjen më të lartë të punësimit (63.4% dhe 60.7% përkatësisht). Krahësuar me një vit më parë, punësimi ndjek një tendencë rritjeje për të gjitha rajonet (rreth 4 pikë përqind) me përjashtim të Rajonit Qendror që mbetet në të njëtin nivel (Tab 4.1.2 dhe 4.1.3). Rajoni Jugperëndimor bën dallin ndër rajonet e tjera në vitin 2022, sepse shfaq një prirje më të lartë për të rritur shkallën e aktivitetit në tregun e punës. Përveç rritjes së punësimit, rritet edhe përqindja e të diplomuarve të papunë dhe që kërkojnë punë pas mbarimit të shkollës (13.1% nga 4.8% në 2021), si dhe ulet shkalla e inaktivitetit (23.4% nga 36% në 2021). Ulja e inaktivitetit i detyrohet zvogëlimit të kategorisë së të papunëve që nuk kërkojnë punë, por edhe më pak nga të diplomuarit prirjen të vijnë më tej studimet në këtë rajon në krahasim me një vit më parë.

Në të njëjtën linjë me rritjen e punësimit, shkalla e inaktivitetit pëson ulje për të gjitha rajonet me përjashtim të Rajonit Qendror, ku ruhen të njëjtat nivele për të gjitha kategoritë e statusit të punësimit. Në të tre rajonet e tjera është rritur përqindja e të papunëve që kërkojnë punë dhe shfaqen më pak të papunë që nuk po kërkojnë punë apo që zgjedhin të ndjekin studime të mëtejshme, duke u aktivizuar potencialisht në tregun e punës.

Tabela 6. Situata aktuale e punësimit sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Të punësuar	58.4%	60.7%	51.9%	63.4%
I/E punësuar	38.3%	39.1%	40.1%	43.4%
I/E vetë-punësuar	10.4%	5.2%	7.0%	9.7%
Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	9.7%	16.4%	4.8%	10.3%

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Pa punë dhe po kërkoj për punë	17.5%	6.6%	16.0%	13.1%
Joaktivë	24.0%	32.7%	32.1%	23.4%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	9.1%	6.0%	11.2%	5.1%
Student/Kursant	14.9%	26.7%	20.3%	18.3%
Tjetër inaktiv	0.0%	0.0%	0.5%	0.0%
TOTAL	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Tabela 7. Situata aktuale e punësimit sipas rajoneve, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Të punësuar	54.1%	60.1%	47.0%	59.3%
I/E punësuar	38.3%	39.6%	28.6%	42.3%
I/E vetë-punësuar	8.3%	6.3%	11.4%	11.1%
Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	7.5%	14.2%	7.0%	5.8%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	12.0%	6.7%	11.9%	4.8%
Joaktivë	33.8%	33.2%	41.1%	36.0%
Pa punë por nuk kërkoj për punë	13.5%	7.6%	20.0%	13.2%
Student/Kursant	18.8%	25.3%	20.5%	22.8%
Tjetër inaktiv	1.5%	0.4%	0.5%	0.0%
TOTAL	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%


Drejtimi i shkollës profesionale është një element tjetër i rëndësishëm me impakt në statusin e punësimit të të diplomuarve nga këto shkolla (Figura 4.1.3) ku janë përfshirë drejtimet me më shumë se 100 të diplomuar të anketuar). Në të dy vitet e fundit, duket se të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm mbajnë vendin e parë përse i përket punësimit pas diplomimit (70.7% në 2022 dhe 70.0% në 2021), duke konfirmuar punësimin më të shpejtë në përputhje me kërkesat e tregut të punës konsideruar peshën që sektori i turizmit ka marrë në ekonominë e vendit vitet e fundit. Ky drejtim ndiqet nga drejtimi i Elektroteknikës (me 67.6% të të diplomuarve) dhe Shërbime mjetesh transporti (SHMT) (me 66.8% të të diplomuarve), të cilët rezultojnë të punësuar pas diplomimit.

Në krahasim me vitin 2020, ka një rritje të përgjithshme të punësimit (brenda vitit pas diplomimit) në të gjitha drejtimet, por një hop më të madh kanë marrë drejtimet e Hoteleri-Turizmit dhe Ekonomi-Biznes, tek të cilat të diplomuarit e punësuar janë

dyfishuar në dy vitet e fundit. Rritja e punësimit për të gjitha drejtimet vijon edhe në vitin 2022 nga viti 2021, përveç një ulje të lehtë të punësimit në TIK (42.6% nga 52.9% në 2021) dhe në Ekonomi-Biznesi (43.6% nga 47.7% në 2021). Praktikisht këto janë drejtimet ku vihet re edhe një shtim i inaktivëve të cilët janë të prirur të studiojnë më tej (52.9% nga 42.6% në TIK dhe 45.7% nga 37.4% në 2021 në Ekonomi-Biznes), duke sugjeruar një tendencë të një kualifikimi më të lartë në këto drejtime, sesa të jenë më aktivë në tregun e punës.

Në vitin 2022, niveli më i lartë i të diplomuarve që ishin të papunë, duke kërkuar aktivisht për punë në momentin e anketimit, shënohet në TIK (me 13.9%), ndërsa më i ulëti në Elektroteknikë (4.3%), gjë që impaktohet nga fakti se të diplomuarit e këtyre profileve kanë më shumë prirje të jenë të punësuar, ose në studime të mëtejshme krahasuar me profilet e tjera. Një vit më parë ishin të diplomuarit në SHMT (12.5%), me përqindjen më të lartë të të papunëve duke kërkuar aktivisht për punë krahasuar me drejtimet e tjera, ndërsa TIK shënonte përqindjen më të ulët (4.3%). Viti 2020, shënonte përqindje relativisht të larta për të gjitha drejtimet sidomos për drejtimin e Mekanikës (43.5%), ndërsa përqindja më e vogël rezultonte për Ekonomi-Biznes (10.9%).

Figura 3. Statusi i punësimit sipas drejtimit, 2020 – 2022



Shënim: Në grafik tregohen drejtimet që kanë më shumë se 100 të diplomuar të anketuar që kanë ndjekur atë drejtim.

Një analizë e statusit të punësimit lidhur me grupet vulnerabël tregon se në vitin 2021, të paktën gjysma e të diplomuarve me përkatësi minoritare (romë apo egjiptianë) ishin të punësuar, dhe rreth 15% e të diplomuarve me aftësi të kufizuara janë të punësuar. Gjithashtu, rreth 50% e të diplomuarve që vijnë nga familje me ndihmë ekonomike rezultojnë të punësuar. Përqindjet më të larta të të diplomuarve të papunë por që ishin duke kërkuar për punë në momentin e anketimit i përkasin të diplomuarve me aftësi

të kufizuar (42.9%). Për të gjitha kategoritë, arsyeja kryesore e mos të qenurit aktiv në tregun e punës ishte vijimi i studimeve apo kualifikimeve të mëtejshme, përveç të diplomuarve me aftësi të kufizuar, inaktiviteti i të cilëve impaktohet nga kategoria e të diplomuarve që janë të papunë por jo në kërkim të saj.

Tabela 8. Statusi i punësimit sipas grupeve (%Po), 2022

	Romë/ Egjiptianë	Aftësi e kufizuar	Nga familje me NE
Të punësuar	53.30%	14.30%	47.70%
I/E punësuar	33.30%	0.00%	33.80%
I/E vetë-punësuar	6.70%	14.30%	4.60%
Punoj dhe studioj në të njëjtën kohë	13.30%	0.00%	9.30%
Pa punë dhe po kërkoj për punë	6.70%	42.90%	17.60%
Inaktivë	40.00%	42.90%	34.70%
Student/Kursant në trajnim të mëtejshëm	33.30%	14.30%	25.90%
Inaktivë të tjerë	6.70%	28.60%	8.80%

4.2 TË DIPLOMUARIT E PUNËSUAR

Seksioni 4.2 pasqyron integrimin e të diplomuarve të punësuar në tregun e punës duke dhënë detaje mbi elementët e tranzicionit (kohën e gjetjes së punës së parë dhe mënyrat e kërkimit), si dhe karakteristikat e punës aktuale. Të dhënat i referohen kategorisë së të punësuarve dhe të vetëpunësuarve.

Tranzicioni drejt tregut të punës – koha e gjetjes së punës së parë

Bazuar në të dhënat e gjurmimit vërejmë se të diplomuarit në arsim profesional priren të marrin pjesë sa më herët në tregun e punës, rreth 85% e tyre e kishin gjetur punën që para përfundimit të studimeve ose në tre muajt e parë që pasonin diplomimin. Në vitin 2021, 58.4% e të diplomuarve të punësuar kishin gjetur punën e tyre të parë që më parë diplomimit, duke mos paraqitur ndryshime të rëndësishme krahasuar me kohortat e vitit 2020 (60.5%) dhe 2021 (57.5%). Ndërkohë vihet re një rritje e konsiderueshme e të diplomuarve, të cilët integrohen në tregun e punës 1 muaj pas diplomimit në dy vitet e fundit, 17.6% në vitin 2022 dhe 21.6% 2021, në krahasim me 10.3% në vitin 2020. Në rënie paraqiten të diplomuarit që kanë arritur të gjejnë punë 1-3 muaj pas diplomimit ndërsa ata që e kanë gjetur punën pas 6 muajsh, ndonëse në përqindje mjaft të vogël shprehin tendencë rritjeje. Kjo sugjeron për një analizë më të thellë, për të kuptuar faktorët që mund të jenë pengues ose bllokues lidhur me aksesin në tregun e punës të kësaj kategorie.

Shpërndarja rajonale tregon se Rajoni Verior ka tranzicionin më të shpejtë në tregun e punës konsideruar që 66.7% e të diplomuarve të këtij rajoni e ka gjetur punën para mbarimit të shkollës. Ndërsa të diplomuarit e Rajonit Juglindor shfaqin një tranzicion

më të ngadaltë në drejtim të tregut të punës, 53.0% e të diplomuarve të këtij rajoni e kishin gjetur punën e tyre të parë para diplomimit, krahasuar me rajonet e tjera (mbi 58%). Ndërsa të diplomuarit në Rajonin Verior kanë një tendencë më të lartë që të punësohen 1 ose 1-3 muaj pas diplomimit (43.4%), krahasuar me të diplomuarit e rajoneve të tjera, në Rajonin Juglindor dhe Jugperëndimor më shumë të diplomuar fillojnë punën e tyre të parë 3-6 ose 6-9 muaj pas diplomimit në krahasim me dy rajonet e tjera. Fasha që përfshin 9-12 muaj pas diplomimit, është e përqëndruar në Rajonin Verior dhe Qendror.

Tabela 9. Puna e parë pas mbarimit të shkollës (si % e të diplomuarve që janë të punësuar) sipas rajoneve, 2020-2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperën- dimor	Total 2022	Total 2021	Total 2020
Që para diplomimit/ mbarimit të shkollës	66.7%	58.0%	53.0%	58.7%	58.4%	57.5%	60.5%
1 muaj pas diplomimit	26.7%	20.7%	24.2%	20.9%	17.6%	21.6%	10.3%
1 - 3 muaj pas diplomimit	16.7%	10.3%	10.6%	13.2%	8.3%	11.4%	18.9%
3 - 6 muaj pas diplomimit	5.0%	3.8%	7.6%	8.8%	7.1%	5.1%	8.0%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0.0%	1.9%	3.0%	4.4%	3.0%	2.2%	1.6%
9 - 12 muaj pas diplomimit	5.0%	2.4%	0.0%	1.1%	5.5%	2.2%	0.6%


Analiza e kohës së integritimit në tregun e punës sipas gjinisë, tregon se meshkujt më shumë se femrat janë të prirur të gjejnë punë pas mbarimit të shkollës (60.8% ndaj 42.7%) dhe këto nivele janë të njëjta me një vit më parë. Meshkujt janë gjithashtu më të prirur të gjejnë punë brenda muajit të parë pas diplomimit, tendencë e kundërt kjo me një vit më parë kur përqindja e femrave që fillonin punë që në muajin e parë ishte dyfish më e lartë se në 2022. Duket se, më shumë femra në vitin e fundit, kanë nisur punë në më shumë se tre muaj pas diplomimit, një përqindje kjo jo vetëm më e lartë së për meshkujt por dhe në rritje nga viti i kaluar.

Tabela 10. Puna e parë pas mbarimit të shkollës (% e të diplomuarve që janë të punësuar) sipas gjinisë, 2022

	2022		2021	
	Femër	Mashkull	Femër	Mashkull
Që para diplomimit/mbarimit të shkollës	42.7%	60.8%	42.1%	60.2%
1 muaj pas diplomimit	15.9%	17.9%	31.6%	19.9%
1 - 3 muaj pas diplomimit	12.2%	7.8%	12.6%	11.2%
3 - 6 muaj pas diplomimit	13.4%	6.1%	4.2%	5.2%
6 - 9 muaj pas diplomimit	4.9%	2.7%	3.2%	2.0%
9 - 12 muaj pas diplomimit	11.0%	4.7%	6.3%	1.5%

Përsa i përket fushave të studimit, të diplomuarit me më shumë prirje për t'u punësuar brenda 3-mujorit të parë, i përkisnin drejtimeve të Hoteleri-Turizmit dhe Elektroteknikës, ndërsa drejtimi që kërkon afat më të gjatë në punësimin e të diplomuarve të kohortës 2022 është Ekonomi-Biznesi.

Figura 4. % e të diplomuarve të punësuar që kanë gjetur punë deri në 3 muaj pas diplomimit sipas drejtimeve, 2022



Ndër të vetë-punësuarit, 65.9% e të diplomuarve punonin në biznesin e familjes, përqindje kjo më e lartë për Rajonin Juglindor (76.9%) dhe atë Verior (71.4%). Megjithatë shumica e të diplomuarve të Rajonit Juglindor ka perspektivën e punësimit në biznesin e familjes, në këtë rajon shfaqet edhe prirja më e fortë për të hapur një biznes në afatshkurtër (brenda 1 muaji nga diplomimi). Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor ishin më të prirur të hapnin biznesin e tyre që para diplomimit (17.6%) apo të ndërtonin bizneset e tyre në afatshkurtër (1 deri në 3 muaj pas diplomimit) në krahasim me rajonet e tjera. Kështu, të diplomuarit e Rajonit Qendror (10.5%) dhe Verior (7.1%) mund të ndërtonin bizneset e tyre në afatmesëm (6 deri në 9 muaj pas diplomimit), ndërsa prirja për të hapur një biznes në afatgjatë (9-12 muaj pas diplomimit) shfaqet më shumë në Rajonin Jugperëndimor. Krahasimi me një vit më parë nuk shfaq ndryshime

të rëndësishme përvec shtimit të të diplomuarve që punojnë në biznesin e familjes, dhe uljes së përqindjes së të diplomuarve të vetë-punësuar që e hapin biznesin e tyre 3-6 muaj pas diplomimit.

Tabela 11. Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total 2022	Total 2021
Është biznesi i familjes	71.4%	63.2%	76.9%	58.8%	65.9%	59.8%
E kam hapur para diplomimit	7.1%	15.8%	15.4%	17.6%	14.6%	13.7%
1 muaj pas diplomimit	7.1%	5.3%	7.7%	5.9%	6.1%	5.9%
1 -3 muaj pas diplomimit	0.0%	0.0%	0.0%	5.9%	1.2%	5.9%
3 - 6 muaj pas diplomimit	7.1%	7.9%	0.0%	0.0%	4.9%	7.8%
6 - 9 muaj pas diplomimit	0.0%	2.6%	0.0%	0.0%	1.2%	2.0%
9 - 12 muaj pas diplomimit	7.1%	5.3%	0.0%	11.8%	6.1%	4.9%

Analiza me këndvështrim gjinor, tregon se përgjithësisht, meshkujt ishin më të prirur të punonin në bizneset familjare (67.5%), ose të hapnin një biznes para diplomimit apo 1 muaj pas diplomimit, krahasuar me femrat. Ndërsa për femrat, nëse hapja e një biznesi nuk ndodhte para diplomimit, atëherë kjo kërkonte një afat kohor më të gjatë se për meshkujt, si p.sh. në afatmesëm, 3-6 muaj (20%) apo afatgjatë, 9-12 muaj (20%) pas diplomimit.

Tabela 12. Koha pas diplomimit për hapjen e biznesit sipas gjinisë, 2022

	Femër	Mashkull	Total
Është biznesi i familjes	40.0%	67.5%	65.9%
E kam hapur para diplomimit	20.0%	14.3%	14.6%
1 muaj pas diplomimit		6.5%	6.1%
1 -3 muaj pas diplomimit		1.3%	1.2%
3 - 6 muaj pas diplomimit	20.0%	3.9%	4.9%
6 - 9 muaj pas diplomimit		1.3%	1.2%
9 - 12 muaj pas diplomimit	20.0%	5.2%	6.1%

Në lidhje me numrin e të punësuarve në biznesin e tyre, 43.9% e të diplomuarve të vetëpunësuar deklaruan se kishin të punësuar 1-3 persona, gjë që vë në dukje orientimin drejt sipërmarrjeve të vogla duke qënë se ky nivel shfaqet mesatarisht në të katërta rajonet, megjithëse me një tendencë uljeje krahasuar me vitin e kaluar. Biznese

pa të punësuar deklarohen nga 22.0% e të diplomuarve të vetëpunësuar, dukuri kjo më e theksuar në Rajonin Verior (35.7%). Ndërsa 34.1% deklaruan se kishin më shumë se 3 persona të punësuar, duke treguar një prirje në rritje drejt sipërmarrjeve pak më të mëdha në krahasim me vitin e kaluar (19.6%). Kjo dukuri është më e theksuar në Rajonin Qendror (44.7%).

Tabela 13. Të punësuar në biznes sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total 2022	Total 2021
Asnjë	35.7%	10.5%	30.8%	29.4%	22.0%	25.5%
1-3 persona	42.9%	44.7%	38.5%	47.1%	43.9%	54.9%
Më shumë se 3 persona	21.4%	44.7%	30.8%	23.5%	34.1%	19.6%

Tranzicioni drejt tregut të punës – mënyra e gjetjes së punës së parë

Mënyra më e shpeshtë sesi të diplomuarit e punësuar priren të gjejnë punën e tyre të parë mbeten njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë në të tre studimet e kryera, megjithëse pesha që zë kjo mënyrë e gjetjes së punës në vitin 2022, (64.3%) është më e ulët se një vit më parë (81.5%). Përdorimi i këtyre kanaleve joformale ishte i përhapur pothuajse njësoj tek të katërta rajonet, por dallohet më shumë në Rajonin Verior (73.6%).

Mënyra e dytë më e përdorur për të gjetur punën e parë nga të diplomuarit (12.0%) ishte nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale etj. ndjekur edhe nga gjetja e punës nëpërmjet praktikës profesionale në biznes (11.9%). Gjetja e punës nëpërmjet lajmërimeve të publikuara ishte më e theksuar në Rajonin Qendror (14.9%) ndërsa gjetja nëpërmjet praktikës profesionale është zhvilluar më shumë në Rajonin Jugperëndimor dhe atë Juglindor duke pësuar një rritje mjaft të theksuar në krahasim me një vit më parë. Edhe gjetja e punës duke kontaktuar drejtpërdrejt punëdhënësin potencial, ka gjithashtu relevancë (6.1%) ndërsa opcionet e tjera nuk kanë treguar të kenë rezultat. Është për t'u theksuar megjithatë, rritja e mundësisë së gjetjes së punës nëpërmjet mësuesve apo instruktorëve në shkollë, 2.7% në vitin 2022, krahasuar me vetëm 0.6% në vitin 2021.

Tabela 14. Mënyra e gjetjes së punës të parë sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total 2022	Total 2021	Total 2020
Nëpërmjet Zyrës së Punës		0.3%			0.2%	0.5%	0.80%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara	8.3%	14.9%	8.5%	6.5%	12.0%	7.1%	3.30%

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total 2022	Total 2021	Total 2020
Nga praktika profesionale në biznes	8.3%	9.3%	18.3%	19.4%	11.9%	4.1%	9.60%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	73.6%	64.2%	56.1%	64.5%	64.3%	81.5%	58.20%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	4.2%	6.9%	6.1%	4.3%	6.1%	5.8%	24.70%
Nga mësuesit/ instruktorët në shkollë		1.9%	8.5%	3.2%	2.7%	0.6%	1.90%
Nëpërmjet një agjencie private të punësimit		0.3%	1.2%	1.1%	0.5%	0.3%	0.20%
Tjetër	5.6%	2.4%	1.2%	1.1%	2.4%		1.20%

Përdorimi i kanaleve të ndryshme të gjetjes së një vendi pune shfaq dallime edhe midis dy gjinive. Meshkujt janë të prirur më shumë se femrat të gjejnë punë nëpërmjet njohjeve dhe kontakteve familjare. Ndërsa femrat janë më të prirura se meshkujt të gjejnë punë nëpërmjet lajmërimeve të publikuara, duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin dhe nga mësuesit apo instruktorët në shkollë, meshkujt kanë më shumë gjasa të gjejnë punë nëpërmjet praktikës profesionale në biznes.

Tabela 15. Gjetja e punës së parë sipas gjinisë, 2021-2022

	2022		2021	
	Femër	Mashkull	Femër	Mashkull
Nëpërmjet Zyrës së Punës	0.00%	0.20%	0.00%	0.60%
Nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara	21.30%	10.70%	16.80%	5.40%
Nga praktika profesionale në biznes	8.80%	12.30%	2.10%	4.50%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve	57.50%	65.30%	76.80%	82.40%
Duke kontaktuar drejtpërdrejt me punëdhënësin tim	7.50%	5.90%	4.20%	6.10%

	2022		2021	
	Femër	Mashkull	Femër	Mashkull
Nga mësuesit/instruktorët në shkollë	5.00%	2.40%	0.00%	0.70%
Nëpërmjet një agjencie private të punësimit	0.00%	0.60%	0.00%	0.40%
Tjetër	0.00%	2.80%	0.00%	0.00%

Integrimi në tregun e punës – karakteristikat kryesore në punën aktuale

Kryesisht, pjesa më e konsiderueshme e të diplomuarve (rreth 74%) që ishin në marrëdhënie pune punonin në ndërmarrje mikro apo të vogla duke reflektuar kështu edhe natyrën e bizneseve në Shqipëri. 42.2% punonin në kompani me më pak se 10 punonjës (dukuri më e shpërfaqur në Rajonin Juglindor (55.9%) ndërsa 31.8% punonin në kompani të vogla me 10-49 punonjës. Pesha e bizneseve mikro është ulur substancialisht në krahasim me një vit më parë, gjë që tregon se kohorta e të diplomuarve në vitin 2022 është punësuar në një numër më të madh ndërmarrjesh të mesme dhe sidomos të mëdha në vend (përkatësisht 13.6% nga 9.2% në 2021, dhe 12.3% nga 4.1% në 2021).

Rreth 14% e të diplomuarve punonin në kompani të mesme me 50-249 punonjës, ndërsa 12.3% punonin në ndërmarrje të mëdha me më shumë se 250 punonjës. Nuk vërehen ndryshime të theksuara midis rajoneve përsa i përket punësimit në ndërmarrjet e vogla ku janë përqëndruar rreth një e treta e të diplomuarves. Punësimi në ndërmarrjet e mesme vërehet më shumë në Rajonin Juglindor (18.5%) dhe Qendror (15.8%), ndërsa në ndërmarrje të mëdha kanë tendencën të punësohen më shumë të diplomuarit në Rajonin Qendror (14.5%) dhe Jugperëndimor (12.9%) krahasuar me rajonet e tjera, duke reflektuar kështu përqëndrimin e bizneseve të tilla në këto rajone.

Tabela 16. Numri i punonjësve në kompaninë ku të diplomuarit punojnë sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total 2022	Total 2021
Ndërmarrje mikro (1-9 punonjës)	50.7%	35.4%	51.9%	55.9%	42.2%	58.9%
Ndërmarrje e vogël (10-49 punonjës)	31.0%	34.4%	25.9%	26.9%	31.8%	27.8%
Ndërmarrje e mesme (50-249 punonjës)	8.5%	15.8%	18.5%	4.3%	13.6%	9.2%
Ndërmarrje e madhe (>250 punonjës)	9.9%	14.5%	3.7%	12.9%	12.3%	4.1%

Lidhur me mënyrën e kontraktimit të të diplomuarvetë punësuar, vetëm 17.0% e të diplomuarve deklarorin se kishin kontratë me afat të caktuar me punëdhënësin në vitin 2022, në ulje të theksuar nga viti i mëprshëm kur kjo përqindje ishte 55.3%. Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor (21.5%) ishin më të prirur të kishin kontratë me afat të caktuar përkundrejt rajoneve të tjera por gjithsesi ky nivel është shumë më i ulët krahasuar me vitin 2021. Si rrjedhim në 2022 ka një rritje të konsiderueshme të të diplomuarve që punojnë me kontratë pa afat (44% kundrejt 25.1% në vitin 2021), dhe e të diplomuarve që ishin të punësuar pa kontratë (37.2% kundrejt 25% në vitin 2021).

Më shumë të diplomuar që punonin pa kontratë shfaqeshin në Rajonin Juglindor (46.3%) përkundrejt të diplomuarve në rajonet e tjera, ndërkohë që të diplomuarit të cilët kishin kontratë pa afat ishin më të shumtë në Rajonin Qendror (49.1%). Vetëm 1.7% e të diplomuarve deklaruan se po bënin praktikë, të përqëndruar më së shumti në Rajonin Juglindor, ndërsa nuk kishte asnjë të tillë në Rajonin Jugperëndimor.

Tabela 17. Lloji i kontratës së punës sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Kontratë me afat të caktuar	15.5%	17.1%	12.5%	21.5%	17.0%
Kontratë pa afat	31.0%	49.1%	33.8%	41.9%	44.0%
Po bëj praktikë	1.4%	1.0%	7.5%	0.0%	1.7%
Jam pa kontratë	52.1%	32.7%	46.3%	36.6%	37.2%

Tabela 18. Lloji i kontratës së punës sipas rajoneve, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Kontratë me afat të caktuar	46.7%	56.9%	39.4%	65.6%	55.3%
Kontratë pa afat	31.7%	17.7%	19.7%	12.2%	18.4%
Po bëj praktikë	0.0%	1.5%	1.5%	0.0%	1.1%
Jam pa kontratë	21.7%	24.0%	39.4%	22.2%	25.1%

Në lidhje me pyetjet mbi sigurinë e vendit të punës apo stabilitetin në punën e tyre aktuale, pak më shumë se 80% e të diplomuarve në marrëdhënie pune deklaruan se ndihen të 'sigurt' apo 'shumë të sigurt' lidhur me situatën e tyre aktuale të punësimit. Ky perceptim ishte më i theksuar në Rajonin Juglindor (me 45% 'të sigurt'), dhe në Rajonin Verior dhe Jugperëndimor (ku më shumë se gjysma e të diplomuarve në marrëdhënie pune ndihen 'shumë të sigurt' në punën e tyre). Këto të dhëna zbulojnë një rritje të perceptimit të stabilitetit në punën aktuale nga ana e të diplomuarve në vitin 2022, në krahasim me vitin e kaluar ku pothuajse gjysma deklarorin një perceptim neutral.

Tabela 19. Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Shumë i/e pasigurt	2.8%	0.8%	3.8%	1.1%	1.4%
I/E pasigurt	0.0%	1.0%	2.5%	2.2%	1.3%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	9.7%	16.3%	22.5%	9.8%	15.4%
I/E sigurt	29.2%	34.1%	45.0%	29.3%	34.2%
Shumë i/e sigurt	58.3%	47.8%	26.3%	57.6%	47.7%

Tabela 20. Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale sipas rajoneve, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Shumë i/e pasigurt	0.0%	10.7%	7.7%	0.0%	7.8%
I/E pasigurt	6.6%	9.9%	9.2%	6.6%	9.0%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	39.3%	46.7%	44.6%	54.9%	47.0%
I/E sigurt	31.1%	23.0%	18.5%	24.2%	23.5%
Shumë i/e sigurt	23.0%	9.7%	20.0%	14.3%	12.7%

Përkatësisht më shumë femra (51.3%) se meshkuj (47.2%) ndihen shumë të sigurt në punën e tyre aktuale, ndërkohë që ka më shumë meshkuj se femra që ndihen thjesht të sigurt. Ndarja gjinore tregon të njëjtin trend dhe nivele mjaft të ulëta për sa i përket pasigurisë/ pasigurisë së lartë në punë me një diferencë shumë të ulët në favor të meshkujve (brenda nivelit 2%).

Tabela 21. Perceptimi i sigurisë (stabilitet) në punën aktuale sipas gjinisë, 2022


	Femër	Mashkull	Total
Shumëi/e pasigurt	0.0%	1.7%	1.4%
I/E pasigurt	1.3%	1.3%	1.3%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	20.0%	14.7%	15.4%
I/E sigurt	27.5%	35.2%	34.2%
Shumë i/e sigurt	51.3%	47.2%	47.7%

Tabela 22. Perceptimi i sigurisë (stabilitetit) në punën aktuale sipas gjinisë, 2021

	Femër	Mashkull	Total
Shumëi/e pasigurt	3.2%	8.6%	7.8%
I/E pasigurt	2.1%	10.3%	9.0%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	64.9%	43.8%	47.0%
I/E sigurt	26.6%	22.9%	23.5%
Shumë i/e sigurt	3.2%	14.4%	12.7%

Në përgjigjet e dhëna mbi ndarjen sipas drejtimeve profesionale del në pah se të diplomuarit e punësuar që kishin mbaruar Ekonomi-Biznes kishin perceptimin më të lartë të sigurisë apo stabilitetit në punë (mbi 90%) krahasuar me 39.6% të një viti më parë. Siguri të lartë dhe shumë të lartë tregojnë gjithashtu drejtimit Hoteleri-Turizëm si dhe drejtimit teknike industriale (mbi 70%). Të gjitha degët e përmendura kanë pësuar rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë por rritja më e theksuar shfaqet në Hoteleri-Turizëm.

Figura 5. Perceptimi i sigurisë (stabilitetit) në punën aktuale sipas drejtimit (shumë të sigurt ose të sigurt), 2021-2022



Për sa i përket perspektivës së vetë-punësimit, 51.9% e të diplomuarve e shihnin sipërmarrjen e tyre si një aktivitet të përhershëm. Të diplomuarit në Rajonin Qendror (62.2%) ishin më të prirur të shikonin përspektivën e vetëpunësimit si një zgjedhje të përhershme krahasuar me të diplomuarit në rajonet e tjera, të cilat megjithatë reflektojnë përqindje të larta. Gati 40% e të diplomuarve e shihnin vetë-punësimin si një aktivitet të përkohshëm deri në një mundësi punësimi pranë një kompanie. Ky perceptim nuk shfaqte ndryshime të qenësishme midis të katër rajoneve.

■ ■

3 Grafiku paraqet perceptimin e të diplomuarve të punësuar për drejtimet profesionale me më shumë se 100 të diplomuar të anketuar.

Tabela 23. Perspektiva e vetë-punësimit sipas rajoneve, 2022


	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
E shoh si një aktivitet të përhershëm timin	50.0%	62.2%	38.5%	41.2%	51.9%
E shoh si një aktivitet të përkohshëm deri në një punësim më të sigurtë në një kompani	50.0%	32.4%	38.5%	47.1%	39.5%
Nuk e di	0.0%	5.4%	23.1%	11.8%	8.6%

Tabela 24. Perspektiva e vetë-punësimit sipas rajoneve, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
E shoh si një aktivitet të përhershëm timin	72.7%	67.3%	42.9%	52.4%	59.8%
E shoh si një aktivitet të përkohshëm deri në një punësim më të sigurtë në një kompani	27.3%	22.4%	52.4%	38.1%	32.4%
Tjetër	0.0%	8.2%	0.0%	4.8%	4.9%
Nuk e di	0.0%	2.0%	4.8%	4.8%	2.9%

Sipas ndarjes gjinore perceptimi mbi perspektivën e vetë-punësimit është më i lartë tek femrat sesa tek meshkujt. 60% e meshkujve dhe 51.3% e femrave shprehen se vetë-punësimin e shohin si një aktivitet të tyre të përhershëm. Vetëm meshkujt janë shprehur se e shohin aktivitetin e tyre si të përkohshëm deri në një punësim më të sigurt pranë një kompanie (42.1%), ndonëse një vit më parë, 20% e femrave të diplomuara të vetë-punësuar që mori pjesë në anketim, ndante këtë mendim.

Figura 6. Perspektiva e vetë-punësimit sipas gjinisë, 2021-2022



Integrimi në tregun e punës – të ardhurat

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet niveli i pagave mujore të të diplomuarve të punësuar duke hedhur dritë mbi detajet e kompensimit financiar të punës sipas rajoneve, gjinisë, drejtimit profesional, si dhe evoluimin e tyre nga viti i mëparshëm. Raportimi në lidhje me pagat e të diplomuarve përfshin si të diplomuarit e punësuar ashtu edhe ata të vetëpunësuar. Përqindja më e lartë ndër fashat e të ardhurave i takonte nivelit 40.001-50.000 lekë, me 32.9% të të diplomuarve të punësuar. Kjo përqindje është edhe më e lartë, nëse konsiderohet shpërndarja rajonale, në Rajonin Juglindor dhe Jugperëndimor, ku përkatësisht 38.7% dhe 37.6% të të diplomuarve të punësuar kishin të ardhura nga puna në këtë nivel.

Ashtu si dhe një vit më parë, niveli i dytë i pagave ishte 32.001-40.000 lekë, ku 16.9% e të diplomuarve të punësuar paguheshin deri në kufirin 40.000 lekë (paga minimale në vitin 2022), me përhapjen më të madhe në Rajonin Verior (28.6% e të diplomuarve në këtë rajon). Niveli i tretë i përket fashës së të ardhurave 60.001-95.000 lekë, ku dallohet Rajoni Qendror me 18.5%. Ndërkohë, vetëm 7.4% e të diplomuarve të punësuar paguheshin me paga të larta dhe shumë të larta: 3.7% në nivelin 95.001-120.000 lekë dhe 3.7% mbi pagën 120.000 lekë. Pavarësisht faktit që përqindjet mbeten në nivele të ulta në lidhje me pagat më të larta, 7.1% në Rajonin Verior dhe në 6.4% në Rajonin Jugperëndimor, këto dy rajone kanë dhe përqindjet më të larta krahasuar me rajonet e tjera në fashën mbi 120.000 Lekë.

Të diplomuarit e punësuar në vitin 2022, gëzojnë me paga më të larta se kohorta e një viti më parë (figura 4.2.5). Ndryshimi i peshës që zënë të diplomuarit e punësuar me pagë në fashën deri në 40.000 lekë i detyrohet faktit që në vitin 2021, paga minimale ishte 32.000 lekë. Vihet re një rënie drastike e të diplomuarve në vitin 2022 që paguhen në fashën deri në 40.000 lekë. Gjithashtu vërehet nga ky krahasim i të dhënave një rritje të konsiderueshme e të diplomuarve të cilët paguhen në nivelet e pagave 50.001 – 95.000 lekë si dhe një rritje të lehtë të të punësuarve që paguhen mbi 95.000 lekë.

Figura 7. Niveli i pagave sipas rajoneve, 2022






Figura 8. Niveli i pagave, 2021-2022




Në grafikonin që vijon pasqyrohet niveli i pagave sipas gjinisë duke vënë në dukje diferencën e theksuar gjinore në paga, me të punësuarat femra që paguheshin më pak se të punësuarit meshkuj. 26.7% e femrave rezultojnë të paguheshin me një pagë nën 40.000 lekë (kufiri minimal) në krahasim me 15.6% të meshkujve. Në kategoritë e tjera të pagave më të larta janë meshkujt që zënë pjesën më të madhe, përveç intervalit 32.001-40.000 lekë, gjë që thekson faktin se më shumë se gjysma e femrave të diplomuara në arsimin profesional dhe të punësuar mbeten në nivelin pak më lart se paga minimale. Trendi i shpërfaqur në vitin 2022, ku më shumë femra paguheshin me paga më të ulëta në krahasim me meshkujt, është i njëjtë me atë të një viti më parë, gjë që tregon për një model të konsoliduar të hendekut gjinor të pagave në vend.

Figura 9. Niveli i pagave sipas gjinisë, 2022



Bazuar në drejtimin profesional të të diplomuarve shpërndarja e nivelit të pagave tregon se përqindjet më të mëdha përqëndrohen rrotull pagës mesatare ekzistuese në vend, në fashat 40.001-60.000 lekë. Të diplomuarit në drejtimet Ekonomi-Biznes dhe Elektroteknikë rezultojnë të kishin më shumë të diplomuar të punësuar me paga më të larta (mbi 60.000 lekë). Krahësuar me të dhënat për vitin 2021, të diplomuarit në Hoteleri-Turizëm dhe në Elektroteknikë ishin më të prirur për të pasur të ardhura në intervalet me paga më të larta (mbi 50.000 lekë). Në të njëjtën kohë, më shumë nga të diplomuarit në Ekonomi-Biznes dhe Elektroteknikë siguronin të ardhura deri në nivelin e pagës minimale prej 40.000 lekë përkundërt drejtimeve të tjera, një trend ky që ruhet që nga viti paraardhës.

Figura 10. Niveli i pagave sipas drejtimeve, 2022



Shënim: Në grafik tregohen drejtimet që kanë më shumë se 100 të diplomuar të anketuar që kanë ndjekur atë drejtim.

Integrimi në tregun e punës – relevanca e arsimit

Relevanca e arsimit është një nga elementët kryesorë në interesin e shkollave me profil profesional dhe studentëve të tyre. Të dhënat e përfshira në këtë seksion, hedhin dritë mbi përshtatshmërinë e profileve të studimit për t'u integruar me sukses në tregun e punës, apo thënë ndryshe, për të pasur akses në punë të cilat lidhen me fushat e studimit në këto shkolla.

Në bazë të të dhënave, 63.4% e të diplomuarve të punësuar, punonin në një punë që lidhej me fushën/profilin që kishin studiuar. Shpërndarja rajonale sipas viteve, tregon se aktualisht më shumë të diplomuar të Rajonit Juglindor, kishin gjetur një punë që lidhej me studimet e tyre, krahasuar me rajonet e tjera të cilat kanë nivele të ngjashme. Në total në vitin 2022, shfaqet një rritje e relevancës së punës me fushën e studimit krahasuar me vitin 2021 kur kjo përqindje ishte 50.5%.

Tabela 25. Relevanca e punës me fushën e studimit sipas rajoneve, 2020-2022

		Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
2022	Po	64.4%	61.5%	72.3%	62.8%	63.4%
	Jo	35.6%	38.5%	27.7%	37.2%	36.6%
2021	Po	50.8%	51.4%	43.9%	50.5%	50.5%
	Jo	49.2%	48.6%	56.1%	49.5%	49.5%
2020	Po	38.8%	54.8%	54.2%	55.0%	52.7%
	Jo	61.2%	45.2%	45.8%	45.0%	47.3%


Të pyetur nëse fusha e aktivitetit lidhet me studimet e kryera, 63.4% e të diplomuarve të vetëpunësuar u shprehën 'po'. Rajoni Juglindor bën dallim krahasuar me rajonet e tjera me një përqindje më të ulët (53.8%) të atyre që pohojnë lidhjen e aktivitetit me studimet. Nga viti 2021, ka një rritje të përputhjes së fushës së aktivitetit me studimet, sidomos për Rajonin Verior dhe Qendror. Pozitiv është fakti që në vitin 2022, ka më shumë të diplomuar që kanë një biznes, natyra e të cilit lidhet me fushën e studimeve, krahasuar me vitin e mëparshëm ku 60% pohonin se aktiviteti aktual nuk i vinte në përdorim njohuritë e marra gjatë studimeve të kryera.

Tabela 26. Relevanca e fushës së aktivitetit të vetë-punësimit me studimet, 2020-2022

		Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
2022	Po	64.3%	65.8%	53.8%	64.7%	63.4%
	Jo	35.7%	34.2%	46.2%	35.3%	36.6%
2021	Po	10.0%	32.7%	61.9%	47.6%	39.6%
	Jo	90.0%	67.3%	38.1%	52.4%	60.4%
2020	Po	27.3%	33.3%	33.3%	57.1%	35.2%
	Jo	72.7%	66.7%	66.7%	42.9%	64.8%


Analiza gjinore tregon se në vitin 2022, përqindja e femrave të vetëpunësuar, natyra e aktivitetit të të cilave lidhej me studimet e kryera, dyfishohet në krahasim me një vit më parë, (80% nga 40% në 2021), si dhe e superon grupin e meshkujve të diplomuar të vetëpunësuar (62.3%). Edhe meshkujt, ndonëse në një shkallë më të vogël në krahasim me femrat rrisin në vitin aktual përqindjen atyre që kanë një biznes në të njëjtën fushë me studimet e kryera.

Figura 11. Relevanca e fushës së aktivitetit të vetë-punësimit me studimet sipas gjinisë, (%Po), 2020-2022




Analiza gjinore e relevancës së punës për të diplomuarit në marrëdhënie pune ka një tendencë të kundërt, ndaj të vetëpunësuarve. Të diplomuarit meshkuj ishin më të prirur për të punuar në një vend pune që lidhej me profilin e studimeve të tyre (67.0%) në krahasim me të diplomuarat femra (38.6%). Edhe nj vit më parë, të punësuarit me pagë për të cilët puna që kryenin lidhej me natyrën e studimeve të kryera kishte diferenca (ndonëse më të zbutura) gjinore.

Figura 12. Lidhja e punës me studimet sipas gjinisë, 2020-2022



Nëse relevanca e punës do të analizohet sipas drejtimeve kryesore të arsimit profesional (me mbi 100 të diplomuar), do të vihej re se, përkatësisht, 82.3% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe 71.3% e të diplomuarve në SHMT punonin në një fushë relevante me studimet e tyre, përkundrajt më pak se një e treta e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe 45.2% në TIK. Ky rezultat, mund të gjejë të njëjtin shpjegim si dhe në raportin e vitit të kaluar, me faktin se pjesa më e madhe e studentëve të këtyre drejtimeve vazhdojnë studimet e larta, ndaj punësimi i tyre mund jetë me kohë të pjesshme dhe përkohësisht jashtë fushës së studimit.

Figura 13. Lidhja e punës me studimet sipas drejtimit, 2020-2022 (% Po)



Relevanca e studimeve në lidhje me vendin e punës është e lidhur dhe gjen shprehje edhe pyetjen nëse janë përdorur njohuritë e fituara gjatë studimeve në vendin e punës. Më shumë se gjysma e të diplomuarve treguan se i përdorën shumë/jashtëzakonisht shumë (52.3%) njohuritë e marra gjatë studimeve në punën aktuale, ndërsa 14.1% treguan përdorim mesatar të njohurive të fituara gjatë shkollës. Të dhënat për vitin 2021 paraqesin të njëjtin trend, me nivele pak më të ulëta të nivelit mesatar dhe aspak/pak të përdorimit të njohurive në punën aktuale.

Në Rajonin Juglindor dhe atë Qendror (56.5% dhe 54.4%) më shumë se gjysma e të diplomuarve të punësuar janë duke i shfrytëzuar shumë ose jashtëzakonisht shumë aftësitë ose arsimimin e tyre në punën aktuale. Të dhënat paraqesin një trend rënës të pohimit pak ose aspak për të gjitha rajonet krahasuar me vitin 2021, si dhe një trend rritës për shkallën e përdorimit në nivelin mesatar ku spikat pozitivisht Rajoni Juglindor.

Tabela 27. Shkalla e përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve në punën aktuale sipas rajoneve, 2020-2022

		Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
2022	Aspak ose pak	30.6%	34.6%	25.0%	39.4%	
	Mesatar	24.7%	11.1%	18.5%	13.8%	
	Shumë ose jashtëzakonisht shumë	44.7%	54.4%	56.5%	46.8%	
2021	Aspak ose pak	54.9%	41.2%	39.0%	50.9%	43.7%
	Mesatar	7.0%	12.3%	6.9%	7.1%	10.4%
	Shumë ose jashtëzakonisht shumë	38.0%	46.5%	54.0%	41.9%	46.0%
2020	Aspak ose pak	60.9%	46.0%	44.5%	44.6%	
	Mesatar	4.3%	4.4%	8.4%	10.9%	6.5%
	Shumë ose jashtëzakonisht shumë	34.8%	49.6%	47.1%	44.6%	46.2%

Gjithashtu, afërsisht i njëjti numër të diplomuarish konfirmon në të njëjtën linjë, relevancën (47.2%) dhe mosrelevancën (35.4%) të pozicionit aktual me studimet. Rreth 50% e të diplomuarve të Rajonit Juglindor dhe Qendror deklarorin se pozicioni aktual lidhet me studimet e tyre në një shkallë 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë'. Të diplomuarit që pohojnë relevancë 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë' të punës me studimet janë më të shumtë në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë, përveç Rajonit Juglindor, në të cilin ka një përqindje më të madhe (25.0% kundrejt 5.5%) të të diplomuarve që deklarorin relevancë të nivelit mesatar. Vihet re, se në fillim të periudhës (viti 2020), ishin të diplomuarit e Rajonit Verior që pohorin në një shkallë më të madhe mungesën e rëndësisë së studimeve lidhur me pozicionin aktual.

Tabela 28. Shkalla e relevancës së pozicionit aktual me studimet sipas rajoneve, 2020-2022

		Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
2022	Aspak ose pak	32.9%	37.1%	26.1%	38.5%	35.4%
	Mesatar	25.9%	14.4%	25.0%	15.6%	17.3%
	Shumë ose jashtëzakonisht shumë	41.2%	48.5%	48.9%	45.9%	47.2%
2021	Aspak ose pak	55.9%	43.5%	42.0%	51.3%	46.9%
	Mesatar	11.8%	10.7%	3.7%	5.5%	9.4%
	Shumë ose jashtëzakonisht shumë	32.3%	45.8%	54.3%	43.2%	43.7%
2020	Aspak ose pak	62.3%	47.6%	44.9%	44.6%	48.3%
	Mesatar	4.3%	4.8%	7.6%	9.9%	6.3%
	Shumë ose jashtëzakonisht shumë	33.3%	47.6%	47.5%	45.5%	45.4%

Në të gjitha rajonet, përgjigja e pyetjes nëse i ka ndihmuar apo jo shkolla në tregun e punës, është përgjithësisht pozitive, dhe perceptimi i krijuar është që shkolla i ka ndihmuar. Vetëm 1% e të diplomuarve në total nga të katër rajonet u shpreh se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar në gjetjen e një pune. Rreth 38% e të diplomuarve në Rajonin Qendror dhe 37% në atë Jugperëndimor shprehen se shkolla i ka ndihmuar për gjetjen e një pune nëpërmjet orientimit për t'u regjistruar te zyra e punës, ndërsa 33.6% e të diplomuarve në Rajonin Verior shprehen se shkolla i ka ndihmuar për gjetjen e një pune nëpërmjet orientimit mbi mundësitë e ndryshme të punësimit. Po në këtë rajon, 25.6% e të anketuarve shprehen se shkolla i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë, ndërsa në Rajonin Qendror, rreth 20% u shprehën se ndihmesa e shkollës qëndronte përgjithësisht tek të të mësuarit e të kërkuarit/aplikuarit për punë. Në përgjithësi, të gjitha opsionet sesi shkolla ndihmonte për të gjetur punë kanë pësuar rritje në 2022, krahasuar me vitin 2021, përveç orientimit për t'u regjistruar në zyrën e punës.

Tabela 29. Ndhimja nga shkolla për të gjetur punë sipas rajoneve, 2021-2022

	Rajoni Veri-or	Rajoni Qen-dror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total 2022	Total 2021
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	16.8%	20.2%	18.9%	13.1%	18.4%	21.7%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	33.6%	25.7%	26.8%	25.5%	26.9%	15.2%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	25.6%	14.7%	19.7%	23.4%	18.3%	6.8%
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	1.6%	0.8%	1.6%	0.7%	1.0%	0.9%
Nëpërmjet orientimit për t'u regjistruar te zyra e punës	21.6%	37.9%	31.5%	37.2%	34.7%	52.2%


4.3 TË DIPLOMUARIT QË PO VAZHDOJNË KUALIFIKIME TË MËTEJSHME

Bazuar në të dhënat e gjurmimit seksioni paraqet analizën mbi të diplomuarit që ishin duke vazhduar studime apo kualifikime të mëtejshme profesionale.

Institucioni Arsimor në të cilin vazhdojnë studimet të diplomuarit


Nga analiza vihet re që nga të diplomuarit e vitit 2021 të cilët vazhdojnë studimet e mëtejshme, 95.5% e tyre vazhdojnë studimet universitare dhe vetëm 4.5% e tyre vazhdojnë formim profesional ose tjetër. Raportin më të lartë të të diplomuarve që vazhdojnë universitetin e ka rajoni Qëndror me 97.4%. Raportin më të lartë, mes rajoneve, të të diplomuarve që vazhdojnë formim profesional e ka Rajoni Juglindor me 8.5% të të diplomuarve dhe më të ulëtën e ka rajoni Qëndror me vetëm 1.9% të të diplomuarve.

Figura 14. Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas institucioneve arsimore dhe rajoneve, 2021-2022



Ndërsa trendi apo tendenca sipas gjinisë për vazhdimin e studimeve në universitet ose kualifikimeve profesionale, në dryshim nga një vit më parë kur meshkujt kishin një tendencë më të lartë për të vazhduar studimet e mëtejshme universitare krahasuar me femrat, në vitin 2022 janë femrat që shfaqin një pjesëmarrje më të lartë në universitet (97.7%) përkundrejt meshkujve (94.6%). Siç është e pritshme, meshkujt në 2022, janë më të prirur për zhvillim të vazhduar profesional përkundrejt femrave (5.1% kundrejt 1.5%).


Figura 15. Të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme sipas gjinisë, 2021-2022



Lidhja mes fushës së studimeve me studimet e mëparshme

Mbi lidhjen midis fushës së studimeve aktuale me studimet e mëparshme 73.7% të diplomuarve që vazhdojnë studime apo kualifikime të mëtejshme të tyre deklarojnë se fusha e studimeve të tyre aktuale lidhet me studimet e tyre të mëparshme. Të diplomuarit e Rajonit Verior dhe Qendror (pothuajse 80%) janë më të prirur për të vazhduar studime apo trajnime të mëtejshme të tyre, të lidhura me studimet e mëparshme. Të diplomuarit e Rajonit Jugperëndimor dhe Juglindor kanë tendencë më të lartë, krahasimisht me rajonet e tjera, të ndjekin studime apo kualifikime të reja, të palidhura me natyrën e studimeve të mëparshme.

Figura 16. Lidhja e fushës së studimeve me studimet e mëparshme sipas rajoneve (%Po), 2020-2022



Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimeve

Bazuar në përgjigjet e arsyeve më të rëndësishme që i shtyjnë ata të zgjedhin studimet e mëtejshme, më shumë se gjysma e të diplomuarve ose 56.2% ka zgjedhur të vazhdojë studimet e mëtejshme për të arritur një kualifikim më të lartë. Kjo paraqitet si arsyeja kryesore në të gjitha rajonet, por është më shumë e theksuar në Rajonin Verior me 65.8% të të diplomuarve.

2 arsytet e tjera më të rëndësishme për të vazhduar studime të mëtejshme janë: rritja e mundësive të tyre të punësimit (22.2%), dhe mundësia e ndjekjes së një tjetër karriere nga ajo e mëparshme. Të diplomuarit e Rajonit Juglindor dhe Jugperëndimor janë më të prirur të ndjekin studime të mëtejshme lidhur me gjetjen e një pune më të mirë ose një karrierë tjetër profesionale. Vetëm 3% afërsisht, pohojnë se vazhdojnë studime apo trajnime të mëtejshme për arsye emigrimi në Rajonin Verior, ndërsa në rajonet e tjera kjo tendencë nuk është e dukshme.

Në të gjitha rajonet më pak se 1% e të diplomuarve kanë zgjedhur të ndjekin studime/trajnime të mëtejshme për shkak se nuk po gjenin dot punë ose për arsye të tjera, dhe kjo arsye është më e dukshme vetëm në Rajonin Qendror (0.6%).

Tabela 30. Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimit sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Për të fituar një kualifikim më të lartë	65.8%	60.4%	34.0%	43.8%	56.2%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	15.8%	19.5%	40.4%	27.1%	22.2%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	18.4%	18.5%	25.5%	27.1%	20.2%
Nuk po gjeja dot punë	0.0%	0.6%	0.0%	0.0%	0.5%
Emigrim	2.9%	0.7%	0.0%	0.0%	0.7%

Tabela 31. Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnimit sipas rajoneve, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Për të fituar një kualifikim më të lartë	62.9%	54.1%	51.0%	64.8%	55.7%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	20.0%	25.2%	21.6%	16.7%	23.4%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	14.3%	19.3%	27.5%	18.5%	19.8%
Nuk po gjeja dot punë	0.0%	0.7%	0.0%	0.0%	0.4%
Tjetër	2.9%	0.7%	0.0%	0.0%	0.7%

Ndarja sipas gjinive në lidhje me arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve apo kualifikimeve paraqet gjithashtu dallime. 59.5% e meshkujve përkundrejt 48.5% e femrave synojnë një kualifikim më të lartë. Ndërsa më shumë femra se meshkuj synojnë rritin mundësitë për të gjetur një punë më të mirë dhe për të ndjekur një karrierë profesionale tjetër nëpërmjet studimeve të mëtejshme.


Tabela 32. Arsyet kryesore të ndjekjes së studimeve/trajnitimit sipas gjinisë, 2021-2022

2021	2022	
	Femër	Mashkull
Për të fituar një kualifikim më të lartë	45.6%	59.2%
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	26.3%	22.4%
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	26.3%	17.5%
Nuk po gjeja dot punë	0.9%	0.3%
Tjetër	0.9%	0.6%

4.4 TË DIPLOMUARIT PA PUNË

Më shumë se një e treta e të diplomuarve të papunë rezultojnë duke kërkuar për një punë në katër javët e fundit para periudhës së anketimit (34.7%). Rajoni me përqindjen më të lartë të të papunëve në kërkim të një pune është ai Juglindor me 43.1%, ndërsa rajoni me përqindjen më të ulët është ai Jugperëndimor me 28.1%. Në këndvështrimin gjinor, 28.2% e femrave të papuna krahasuar me 36.4% e meshkujve janë aktive në kërkimin e një pune në katër javët e fundit.

Figura 17. Të diplomuar të papunë (në kërkim të një pune në 4 javët e fundit) sipas rajoneve (%Po), 2020-2022



Të kërkuarit për punë

Sipas studimit të gjurmimit të gjithë të diplomuarit e papunë që kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve para momentit të anketimit, përgjigjen se mënyra më e zakonshme që kanë përdorur është nëpërmjet njohjeve familjare dhe miqësore (50.0% pohojnë se kanë zgjedhur këtë mënyrë në krahasim me 80% në vitin 2021) dhe nëpërmjet Zyrave të Punës (35.7%). Mënyra e kërimit për punë nga ana e të diplomuarve nëpërmjet Zyrave të Punës ka pësuar rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë (vetëm 10% e tyre e preferonin këtë mënyrë në 2021). Dy mënyrat e tjera më të rëndësishme: kërkitimi i punës nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në mediat e ndryshme (21.4%), si dhe kontakti i drejtpërdrejtë me punëdhënësin (21.4%) kanë shfaqur gjithashtu një tendencë të fortë rritjeje krahasuar me një vit më parë, duke e bërë kanalin e kërimit të punës nëpërmjet njohjeve dhe familjare më pak të rëndësishëm.

Në tabelën më poshtë shihet edhe shpërndarja e përgjigjeve sipas rajoneve, ku për të katërta rajonet mënyrat më të përdorura për të kërkuar një punë janë njohjet familjare dhe miqësore, ndërsa në Rajonin Qendror dhe Juglindor janë më të përdorura kanalet e ndryshme të informimit. Të diplomuarit e papunë në Rajonin Juglindor dhe Qendror nuk konsiderojnë aspak ose fare pak Zyrat e Punës, si dhe ka një përqindje mjaft të ulët të atyre që bëjnë aplikime të drejtpërdrejta tek punëdhënësit potencialë, për të kërkuar punë.

Tabela 33. Mënyra e të kërkuarit për punë sipas rajoneve, 2022

Mënyra e të kërkuarit për punë	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nëpërmjet Zyrës së Punës	35.7%	3.3%	0.0%	33.3%	35.7%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	21.4%	73.3%	63.6%	22.2%	21.4%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve.	50.0%	36.7%	54.5%	33.3%	50.0%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	21.4%	13.3%	4.5%	11.1%	21.4%
Tjetër				11.1%	

Tabela 34. Mënyra e të kërkuarit për punë sipas rajoneve, 2021

Mënyra e të kërkuarit për punë	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nëpërmjet Zyrës së Punës	0.0%	10.5%	16.7%	0.0%	10.0%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	66.7%	65.8%	75.0%	75.0%	68.3%

Mënyra e të kërkuarit për punë	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve.	100.0%	81.6%	58.3%	100.0%	80.0%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	0.0%	7.9%	0.0%	0.0%	5.0%

Në tabelën e mëposhtme tregohet shpërndarja e përgjigjeve lidhur me mënyrën e të kërkuarit për punë nga të diplomuarit që nuk janë të punësuar sipas gjinisë. Meshkujt janë më të prirur t'u përgjigjen lajmërimeve të publikuara për punë dhe të përdorin kanalet informale të njohjes dhe lidhjeve familjare, ndërsa femrat i përdorin kontaktet familjare dhe miqësore për të gjetur punë krahasimisht edhe me kontaktimet e Zyrës së Punës për mundësi vakante punësimi. Kjo mënyrë e dytë është rritur ndjeshëm për femrat në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë (35.7% kundrejt 14.3% respektivisht).

Tabela 35. Mënyra e të kërkuarit për punë sipas gjinisë, 2021-2022

Mënyra e të kërkuarit për punë	2021		2022	
	Femër	Mashkull	Femër	Mashkull
Nëpërmjet Zyrës së Punës	14.3%	3.9%	35.7%	5.1%
Nëpërmjet lajmërimeve të publikuara në faqe interneti, media sociale, gazetë etj.	42.9%	41.6%	35.7%	46.9%
Nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve, të njohurve.	42.9%	50.6%	21.4%	38.0%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim (duke dërguar CV etj.)	0.0%	3.9%	7.1%	10.1%

Për sa i përket arsyes parësore që të diplomuarit e papunë nuk kanë kërkuar për një punë në 4 javët e fundit para intervistës, ajo është e lidhur me planet për t'u larguar nga vendi (37.3% kanë pohuar kështu). Dy arsyet e tjera më të rëndësishme janë se nuk kanë dëshirë të punojnë për momentin (25.4%), ose presin sezonin e përshtatshëm (14.1%). Planet për emigrim janë më të theksuara në Rajonin Verior (50.0%), por janë në nivele të larta në të gjitha rajonet (më shumë se 30%). Rreth 40% e të diplomuarve të papunë në Rajonin Jugperëndimor shfaqin mungesë dëshire për të punuar, përqindja më e lartë në krahasim me rajonet e tjera, dhe po në këtë rajon shfaqet edhe përqindja më e lartë e atyre që presin sezonin e përshtatshëm (17.4%). Kujdesi për fëmijët/familjen, kushtet shëndetësore, apo mungesa e besimit, mbetën ndër arsyet më pak të rankuara për të mos kërkuar punë.

Tabela 36. Arsyeja e të mos kërkuarit për punë sipas rajoneve, 2022

Arsyeja e të mos kërkuarit për punë	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nga sëmundja ose paaftësia	0.0%	3.3%	3.3%	4.3%	2.8%
Kujdesem për fëmijët/familjen	3.6%	4.9%	0.0%	0.0%	2.8%
Po pres të filloj punë së shpejti	10.7%	8.2%	6.7%	0.0%	7.0%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	7.1%	16.4%	13.3%	17.4%	14.1%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	14.3%	26.2%	23.3%	39.1%	25.4%
Nuk kam besim se do gjej një punë	3.6%	4.9%	6.7%	0.0%	4.2%
Kam në plan të largohem nga vendi	50.0%	34.4%	33.3%	34.8%	37.3%
Tjetër	10.7%	1.6%	13.3%	4.3%	6.3%

Analiza gjinore tregon se nuk paraqiten dallime të forta sidomos përsa i përket arsyeve më të rëndësishme, 37.7% e meshkujve të papunë, që nuk janë në kërkim të një pune, synojnë emigracionin kundrejt 37.9% të femrave të diplomuara të papuna. Kjo situatë është e ndryshme nga një vit më parë kur shfaqej fenomeni social i emigracionit tradicionalisht i dominuar nga meshkujt (51.9% e meshkujve kishte në plan të largohesh nga vendi kundrejt 16.0% të grave që kishin këtë synim) . 31.0% e femrave përkundrejt 23.7% të meshkujve shfaqin mungesë dëshire për të punuar, ndërsa 10.3% e femrave të diplomuara të papuna krahasuar me 0.9% e meshkujve ishin të angazhuara në punë të papaguar dhe nuk ishin duke synuar punësimin, gjë që e cila tregon për theksimin e rolit tradicional të grave në kujdesin e fëmijëve ose familjes edhe në vitin 2022.

Tabela 37. Arsyeja e të mos kërkuarit për punë sipas gjinisë, 2022

Arsyeja e të mos kërkuarit për punë	Femër	Mashkull	Total
Nga sëmundja ose paaftësia	3.4%	2.6%	2.8%
Kujdesem për fëmijët/familjen	10.3%	0.9%	2.8%
Po pres të filloj punë së shpejti	3.4%	7.9%	7.0%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	10.3%	14.9%	14.0%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	31.0%	23.7%	25.2%
Nuk kam besim se do gjej një punë	0.0%	5.3%	4.2%
Kam në plan të largohem nga vendi	37.9%	37.7%	37.8%
Tjetër	3.4%	7.0%	6.3%


Tabela 38. Arsyeja e të mos kërkuarit për punë sipas gjinisë, 2021

Arsyeja e të mos kërkuarit për punë	Femër	Mashkull	Total
Nga sëmundja ose paaftësia	4.0%	3.2%	3.3%
Kujdesem për fëmijët/familjen	16.0%	2.6%	4.4%
Po pres të filloj punë së shpejti	4.0%	12.2%	11.0%
Po pres për sezonin e përshtatshëm	8.0%	2.6%	3.3%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	32.0%	14.7%	17.1%
Nuk kam besim se do gjej një punë	4.0%	2.6%	2.8%
Kam në plan të largohem nga vendi	16.0%	51.9%	47.0%
Tjetër	16.0%	10.0%	11.0%

Marrëdhënia me zyrat e punës

Më së shumti të diplomuarit e papunë në kërkim të një pune (83.6%) pohojnë se nuk janë regjistruar në zyrat e punës për të gjetur një punë. Nuk vihen re dallime të theksuara mes rajoneve, por gjithsesi Rajoni Qendror dhe Juglindor karakterizohen nga më shumë punëkërkues që nuk janë të regjistruar pranë Zyrës së Punës (90.1% dhe 84.0%). Trendi rritës i regjistrimeve në krahasim me një vit më parë është i ngjashëm për të gjitha rajonet por më i theksuar në Rajonin Verior dhe Juglindor.

Figura 18. Punëkërkues të papunë të regjistruar tek Zyra e Punës sipas rajoneve (%Jo), 2021-2022



Mbi bazën e përgjigjeve të dhëna në të katërta rajonet, mbi arsyet e mosregjistrimit në Zyrën e Punës, pjesa më e madhe është shprehur se nuk kanë interes të regjistrohen, gjë që është më e theksuar në Rajonin Qendror (me 79%). Megjithatë, në krahasim me një vit më parë është ulur dukshëm përqindja e të diplomuarve që shfaqin mungesë interesi (88.6% në 2021) dhe janë rritur përqindjet e të diplomuarve që pohojnë se nuk dinë si të regjistrohen (13.7% në 2022, nga 2.7% në 2021). Mungesa e besimit tek ky institucion gjithashtu ka një rritje të lehtë por më të theksuar në Rajonin Juglindor dhe Jugperëndimor (rreth 20%). Përqindje të larta të të diplomuarve të papunë që nuk janë

të informuar rreth procesit të regjistrimit në zyrat e punës shihen sidomos në Rajonin Jugperëndimor (24%).

Tabela 39. Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas rajoneve, 2022


Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jug-perëndimor	Total
Nuk di si të regjistrohem	13.3%	11.1%	12.8%	24.0%	13.7%
Nuk besoj se do të më ndihmoj	16.7%	7.4%	20.5%	20.0%	13.7%
Nuk kam interes të regjistrohem	56.7%	79.0%	53.8%	52.0%	65.7%

Tabela 40. Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas rajoneve, 2021

Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Nuk di si të regjistrohem	3.8%	2.0%	3.6%	0.0%	2.4%
Nuk besoj se do të më ndihmoj	7.7%	9.0%	14.5%	0.0%	9.0%
Nuk kam interes të regjistrohem	88.5%	89.0%	81.8%	100.0%	88.6%


Bazuar në të dhënat e ndarjes gjinore, më shumë femra (73.3%) se meshkuj (64.4%) shfaqin mungesë interesi për t'u regjistruar në Zyrën e Punës. Meshkujt shfaqen më pak besues (15.1%) se femrat (6.7%) ndaj ndihmesës që mund të japë ky institucion, dhe si rrjedhim nuk regjistrohen pranë Zyrës së Punës, ndërsa më shumë femra pohojnë se nuk dinë si të regjistrohen (20.0%) kundrejt meshkujve (12.3%).

Figura 19. Arsyeja e mosregjistrimit tek Zyra e Punës sipas gjinisë, 2021-2022




Pothuajse gjysma e të diplomuarve të papunë që janë regjistruar pranë zyrave të punës (48.6%) pohojnë se zyra e punës po i ndihmon në gjetjen e një pune me informacion rreth vendeve të lira të punës, dhe më pak (rreth 6%) me trajnim ose me këshilla se si të kërkojnë për punë, ndërsa pjesa tjetër (rreth 43%) deklaron se zyra e punës nuk po i ndihmon për të gjetur një punë.

Figura 20. Ndhimja e Zyrës së punës për të gjetur një punë, 2022



Bazuar në ndarjen rajonale, më shumë se gjysma e të diplomuarve të regjistruar si punëkërkuar të papunë në Rajonin Juglindor dhe Jugperëndimor, shprehen se nuk ishin ndihmuar nga Zyra e Punës, ndërsa në Rajonin Qendror dhe Verior, përkatësisht 66.7% dhe 54.5% ishte ndihmuar me informacion mbi vendet e lira të punës nga kjo e fundit. Në Rajonin Juglindor, gjendet përqindja më e ulët e të diplomuarve që janë ndihmuar nga zyrat e punës me informacion mbi vendet vakante (25%), por në të njëjtën kohë ky rajon ka edhe përqindjen më të lartë (12.5%) të atyre që janë ndihmuar me këshilla se si të kërkojnë një punë.


Figura 21. Ndhimja e Zyrës së punës për të gjetur një punë sipas rajoneve, 2022



Nga këndvështrimi gjinor, më shumë se 70% e femrave të anketuara shprehen se ishin ndihmuar me informacion për vendet vakante të punës, krahasuar me 42.8% të meshkujve. Pothuajse gjysma e meshkujve kundrejt një të tretës së femrave u shprehën se nuk ishin ndihmuar nga Zyra e Punës për aspekte të punësimit, ndërsa

këshillimet se si të kërkojnë për punë shfaqen vetëm për meshkujt dhe në nivele të ulëta (vetëm 7%).


Figura 22. Ndhimja e Zyrës së punës për të gjetur një punë sipas gjinisë, 2022



Të diplomuarit e papunë në kërkim të një pune që kanë qenë të punësuar më parë

Rreth 46.0% e të diplomuarve të papunë, përgjigjen se kanë qenë të punësuar më parë, ndërkohë që pjesa tjetër nuk ka punuar asnjëherë. Raportin më të lartë të të diplomuarve të papunë që kanë qenë të punësuar më parë e ka Rajoni Qendror me 56.5% të punësuar më parë. Ndërsa për të diplomuarit nga rajonet e tjera ky raport shfaq më shumë të papunësuar më parë përkundrejt të punësuarve. Ndarja gjinore tregon se 57.9% e femrave të papuna, kundrejt 45.4% të meshkujve të papunë, kanë qenë të paktën njëherë të punësuar që nga koha e diplomimit.


Figura 23. Të punësuar që nga koha e diplomimit/mbarimit të shkollës sipas rajoneve, 2021-2022



4.5 VLERËSIMI RETROSPEKTIV I TË DIPLOMUARVE PËR SHKOLLËN

Gjetjet kryesore të vlerësimit retrospektiv të të diplomuarve nga arsimi profesional për institucionin ku kanë ndjekur studimet pasqyrohen në këtë seksion. Rreth 84.4% e të diplomuarve do të zgjidhnin sërish të njëjtën shkollë nëse do të kishin mundësi, dhe ky perceptim nuk shfaq dallime të theksuara bazuar në gjini. Pjesa dërrmuese e të dy gjinive, ose 84.8% e femrave dhe 82.4% e meshkujve do të zgjidhnin të njëjtën shkollë. Krahasuar me vitin 2021, më shumë të diplomuar meshkuj do të zgjidhnin sërish njëjtën shkollë.

Figura 24. Zgjedhja e të njëjtës shkollë sipas gjinisë, 2020-2022



Bazuar në përgjigjet e pyetjes nëse do të zgjidhnin të njëjtin drejtim ose jo, vërejmë se 82.6% e të diplomuarve shprehen se do të zgjidhnin të njëjtin drejtim, pa dallime gjinore, përkundër një viti më parë kur meshkujt më shumë se femrat ishin të prirur të ndërronin degë. Rreth 88% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes u shprehën se do të rizgjidhnin të njëjtin drejtim duke përbërë më shumë të diplomuar që kanë këtë mendim krahasuar me vitin e kaluar. Po kështu, mbi 80% e të diplomuarve në Hoteleri-Turizëm dhe Elektroteknikë do të rizgjidhnin të njëjtën fushë studimi, me përqindje ndjeshëm më të larta krahasuar me 2021 duke shprehur një konsolidim të preferencës për këto drejtime në vijim.

Figura 25. Zgjedhja e të njëjtës degë/drejtim sipas gjinive (%Po), 2021-2022





Figura 26. Zgjedhja e të njëjtës degë/drejtim sipas drejtimeve (%Po), 2021-2022



Në pyetësonin e gjurmimit u kërkuua vlerësimi i disa aspekteve të shkollës si: infrastruktura, kurrikulat, mësimdhënia, tekstet mësimore, praktika, këshillimi i karrierës, bashkëpunimi i shkollës me zyrën e Punës, bizneset etj, me qëllim kuptimin e nevojave të nxënësve dhe për të ndihmuar në përmirësimin e tyre të mëtejshëm. Pyetjet u formuluan në mënyrë të tillë që i anketuari të kishte mundësi të zgjidhte përgjigjen nëpërmjet alternativave të parashikuara në pyetësor të cilat ishin të shkallëzuara sipas shkallës Likert. Gjatë fazës së përpunimit përgjigjet e të intervistuarve u grupuan nga 5 në 3 shkallë përmbledhëse: a) aspak dhe pak; b) mesatar si dhe c) shumë dhe jashtëzakonisht shumë. Në tabelën më poshtë paraqiten rezultatet për kategorinë e vlerësimit më të lartë, aspektet e vlerësuara me 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë'.

Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës dhe metodat e mësimdhënies kanë përqindjen më të lartë të vlerësimit, ku 86.4% dhe 83.7% e të diplomuarve shprehen se i vlerësojnë 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' këto aspekte, përsa i përket nivelit të përgatitjes për në tregun e punës. Ky vlerësim është më i gjerë sidomos në Rajonin Jugperëndimor, ku përqindja e të diplomuarve që vlerësojnë 'shumë/jashtëzakonisht shumë' metodat e mësimdhënies dhe aftësitë teorike dhe praktike të stafit, është mbi 90%. Infrastruktura është gjithashtu një aspekt që vlerësohet nga më shumë se 80% e të diplomuarve me kategorinë 'shumë/jashtëzakonisht shumë' dhe ky vlerësim është më i lartë në Rajonin Verior. Ky aspekt paraqitet me një rritje të përqindjes së të diplomuarve që japin vlerëimin më të lartë në krahasim me një vit më parë. Praktikën në shkollë dhe në biznese vlerësohen me kategoritë 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' nga respektivisht 79.4% dhe 76.9% e të anketuarve, pa dallime të rëndësishme ndërmjet rajoneve, me përjashtim të Rajonit Verior, i cili ka një përqindje më të ulët të të diplomuarve që e vlerësojnë praktikën në shkollë me këto kategori. Tekstet dhe materialet mësimore, si dhe kurrikulat vlerësohen me kategoritë e vlerësimit më të lartë nga 74.0% dhe 72.8% të të diplomuarve përkaësisht, me një përqindje më të lartë në Rajonin Jugperëndimor përsa i përket materialeve mësimore (77.9%). Aspektet e tjera si, bashkëpunimi i shkollës me bizneset dhe këshillimi i karrierës vlerësohen nga 69.3% dhe 67.8% e të diplomuarve të anketuar, ndërsa bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës edhe pse ka përqindjen më të ulët të të diplomuarve që e vlerësojnë 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë këtë aspekt' (60.9%), shpreh një tendencë rritjeje në krahasim me një vit më parë.

Tabela 41. Aspektet që janë vlerësuar ‘shumë dhe jashtëzakonisht shumë’ në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Infrastruktura	85.0%	82.8%	80.9%	80.9%	82.5%
Kurrikulat	70.8%	70.8%	70.8%	70.8%	72.8%
Tekstet dhe materialet	74.5%	73.4%	72.4%	77.9%	74.0%
Metodat e mësimdhënies	79.9%	84.0%	79.3%	90.0%	
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	82.8%	86.4%	84.5%	91.8%	86.4%
Praktika në shkollë	70.3%	80.6%	81.1%	79.7%	
Praktika në biznes	74.5%	77.8%	77.0%	75.0%	
Këshillimi karrierës	73.1%	67.2%	63.7%	69.8%	
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	69.6%	67.4%	72.4%	73.8%	
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	61.7%	58.8%	62.6%	66.5%	60.9%

Tabela 42. Aspektet që janë vlerësuar ‘shumë dhe jashtëzakonisht shumë’ në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas rajoneve, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Infrastruktura	69.5%	80.7%	75.0%	73.1%	77.6%
Kurrikulat	68.7%	86.7%	74.6%	75.9%	81.5%
Tekstet dhe materialet	74.8%	88.7%	88.6%	82.8%	85.8%
Metodat e mësimdhënies	76.3%	91.9%	93.4%	91.9%	90.5%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	82.9%	94.0%	95.1%	96.8%	93.4%
Praktika në shkollë	70.7%	87.7%	92.3%	95.1%	87.8%
Praktika në biznes	75.8%	87.6%	90.8%	94.6%	87.9%
Këshillimi karrierës	64.9%	65.0%	76.2%	85.3%	69.6%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	63.2%	73.4%	73.4%	86.8%	74.3%
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	51.9%	53.1%	62.0%	81.7%	58.4%

Në tabelën 2.5.3 paraqiten rezultatet për kategorinë e vlerësimit më të ulët, aspektet e vlerësuara me ‘aspak/pak’. Bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës perceptohet nga 19.0% e të diplomuarve si aspekti që është vlerësuar më pak, dhe kjo është më e dukshme në Rajonin Verior. Dy aspektet e tjera të kategorizuara me vlerësimin më të ulët ‘pak pse aspak’ janë këshillimi i karrierës (14.8%), dhe bashkëpunimi i shkollës me bizneset (13.2)%, ndjekur nga praktika në biznes dhe praktika në shkollë (me 8.6% dhe 7.5% përkatësisht).

Tabela 43. Aspektet që janë vlerësuar ‘pak dhe aspak’ në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Infrastruktura	6.1%	5.8%	6.0%	6.4%	5.9%
Kurrikulat	9.0%	5.4%	6.0%	6.4%	6.1%
Tekstet dhe materialet	6.2%	5.5%	3.3%	7.6%	5.6%
Metodat e mësimdhënies	4.9%	4.4%	3.4%	3.5%	4.2%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	4.8%	4.6%	3.3%	4.1%	4.4%
Praktika në shkollë	15.9%	6.6%	4.4%	7.0%	7.5%
Praktika në biznes	10.3%	8.1%	6.2%	11.6%	8.6%
Këshillimi karrierës	10.3%	15.7%	14.3%	15.1%	14.8%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	10.8%	14.8%	9.4%	12.8%	13.2%
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	32.1%	19.4%	17.9%	9.1%	19%

Tabela 44. Aspektet që janë vlerësuar ‘pak dhe aspak’ në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas rajoneve, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Infrastruktura	2.3%	3.3%	1.7%	1.1%	2.6%
Kurrikulat	3.1%	3.0%	1.7%	1.6%	2.6%
Tekstet dhe materialet	6.1%	4.5%	2.7%	3.2%	4.2%
Metodat e mësimdhënies	9.2%	2.9%	3.3%	1.1%	3.3%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	3.9%	1.6%	1.1%	1.1%	1.7%
Praktika në shkollë	15.4%	4.8%	4.4%	2.7%	5.5%

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Jug-lindor	Rajoni Jugperëndimor	Total
Praktika në biznes	17.7%	6.5%	4.3%	2.7%	6.7%
Këshillimi karrierës	8.4%	5.5%	4.3%	0.5%	4.9%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	23.3%	8.5%	8.2%	5.3%	9.5%
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	32.1%	19.4%	17.9%	9.1%	19%

Përsa i përket dallimeve gjinore në vlerësimin e aspekteve të shkollës me kategorinë më të lartë të vlerësimit ‘shumë dhe jashtëzakonisht shumë’ lidhur me përgatitjen për në tregun e punës, përgjithësisht janë femrat që shfaqin përqindje pak më të larta se meshkujt. Bën dallim aspekti i bashkëpunimit të shkollës me bizneset ku vetëm 14.3% e femrave japin vlerësimin më të lartë kundrejt 67.5% të meshkujve.

Tabela 45. Aspektet që janë vlerësuar ‘shumë dhe jashtëzakonisht shumë’ në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas gjinisë, 2022

	Femër	Mashkull	Total
Infrastruktura	86.1%	81.7%	82.5%
Kurrikulat	73.1%	72.7%	72.8%
Tekstet dhe materialet	78.4%	73.1%	74.0%
Metodat e mësimdhënies	85.1%	83.4%	83.7%
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	87.4%	86.2%	86.4%
Praktika në shkollë	79.7%	79.3%	79.4%
Praktika në biznes	81.2%	75.9%	76.9%
Këshillimi karrierës	70.3%	67.2%	67.8%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	14.3%	67.5%	69.3%
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	67.7%	59.4%	60.9%


Tabela 46. Aspektet që janë vlerësuar ‘shumë dhe jashtëzakonisht shumë’ në nivelin e përgatitjes për në tregun e punës sipas gjinisë, 2021

Fushat për përmirësim	Femër	Mashkull	Total
Infrastruktura	78.60%	77.40%	77.6%
Kurrikulat	86.10%	80.50%	81.5%
Tekstet dhe materialet	91.60%	84.60%	85.8%
Metodat e mësimdhënies	91.2%	90.3%	90.5%

Fushat për përmirësim	Femër	Mashkull	Total
Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës	95.8%	92.9%	93.4%
Praktika në shkollë	90.6%	87.2%	87.8%
Praktika në biznes	86.6%	88.2%	87.9%
Këshillimi karrierës	65.1%	70.5%	69.6%
Bashkëpunimi i shkollës me bizneset	71.6%	74.8%	74.3%
Bashkëpunimi i shkollës me Zyrat e Punës	53.9%	59.4%	58.4%

Të pyetur rreth pritshmërive të tyre për 2 vitet e ardhshme, në 31.4% të rasteve, të diplomuarit e anketuar planifikonin të gjenin një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, dhe në 23.2% të rasteve dëshironin të kishin filluar një biznes të tyre. Vihet re një rritje e konsiderueshme e të diplomuarve që dëshironin të ndiqnin studime të mëtejshme (dyfishuar nga në vit më parë) dhe ulje të dëshirës për migrim në një qytet tjetër.

Figura 27. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme, 2021- 2022 (%)



Ndarja sipas rajoneve nuk tregon për dallime të rëndësishme midis rajoneve, përveç një përqindjeje më të madhe të të diplomuarve në Rajonin Qendror dhe Verior për të vijuar studime të mëtejshme (23% dhe 19.6% respektivisht).

Tabela 47. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas rajoneve, 2022

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Të jem i/e punësuar	4.9%	8.7%	11.1%	4.5%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit/trajnimin	32.4%	32.2%	27.2%	32.1%
Të kem filluar biznesin tim	22.5%	22.1%	26.1%	25.0%


	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	19.6%	23.4%	15.3%	20.1%
Të kem emigruar jashtë vendit	15.7%	11.3%	13.8%	13.8%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	0.0%	0.3%	2.3%	0.4%
Tjetër	4.9%	2.0%	4.2%	4.0%

Tabela 48. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas rajoneve, 2021

	Rajoni Verior	Rajoni Qendror	Rajoni Juglindor	Rajoni Jugperëndimor
Të jem i/e punësuar	13.1%	13.1%	11.2%	16.4%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit/trajnimit	24.4%	16.7%	14.7%	12.1%
Të kem filluar biznesin tim	23.8%	25.7%	25.9%	20.1%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	8.1%	10.2%	15.2%	6.1%
Të kem emigruar jashtë vendit	26.3%	22.0%	26.3%	22.4%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	0.6%	0.5%	0.0%	0.0%
Tjetër	3.8%	11.9%	6.7%	22.9%

Ndarja gjinore tregon se femrat, më shumë se meshkujt synojnë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit dhe të ndjekin studime të mëtejshme, duke nënvizuar rëndësinë praktike të studimeve për femrat. Ndërsa të diplomuarit meshkuj aspirojnë më shumë për të filluar një biznes të tyre dhe për të emigruar krahasimisht me femrat.

Figura 28. Pritshmëritë për 2 vitet e ardhshme (%) sipas gjinisë, 2022





5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Gjurmimi i kryer në nivel kombëtar i të diplomuarve të vitit 2022 në rajonin Verior, Qendror, Juglindor dhe Jugperëndimor shpalosi një informacion të qartë mbi situatën e punësimit në vend, mbi të dhënat për të diplomuarit e punësuar dhe ata të papunë, apo të diplomuarit në vijim të arsimimit dhe kualifikimeve të mëtejshme, si dhe një tablo analitike mbi vlerësimin retrospektiv dhe përvojën e të diplomuarve.

Analiza tregoi se prinja e të diplomuarve që vijnë nga shkollat e arsimit profesional në 2022, ashtu si dhe në vitet paraardhëse ishte me përqindje më të lartë tek meshkujt (81.3%), duke e pasqyruar të tillë edhe gjendjen e anketimit në përgjithësi, në përfundim të anketimit 82% e të anketuarve ishin meshkuj. Drejtimet më të përfaqësuar ishin Hoteleri-Turizëm, Shërbime Mjetesh Transporti, Ekonomi-Biznes, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, dhe Elektroteknikë. Shpërndarja sipas rajoneve e të anketuarve tregon se më shumë se gjysma e të anketuarve, rreth 58.6% i përkasin Rajonit Qendror, ndërsa tre rajonet e tjera variojnë nga 12.3% deri në 15%. Rajoni Jugperëndimor karakterizohet nga më shumë të punësuar (63.4%), i ndjekur nga Rajoni Qendror me 60.5%. Përsa i përket të papunëve shifrën më të lartë e ka Rajoni Verior me 16.2%, ndërsa për të diplomuarit që vazhdojnë studime të mëtejshme përqindjen më të lartë e ka Rajoni Qendror me 26.7%. Drejtimet Hoteleri-Turizëm dhe Shërbim Mjetesh Transporti janë me numrin më të lartë të të diplomuarve të punësuar, duke konfirmuar kështu orientimin e formimeve profesionale drejt kërkesave të tregut. Të diplomuarit meshkuj ishin më të prirur se të diplomuarat femra për të qenë të punësuar përkatësisht me 63.5% kundrejt 39.8%.

Të dhënat që hedhin dritë mbi situatën aktuale të punësimit të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve, tregon se më shumë se gjysma e të diplomuarve kanë qenë punësuar para diplomimit të tyre, dhe në Rajonin Verior ky fenomen mban përqindjen më të lartë (66.7%). Rreth një e treta e të diplomuarve të punësuar e gjejnë punën brenda një afati të shkurtër (në tre-mujorin e parë pas diplomimit) pa dallime të rëndësishme midis rajoneve, ndërsa punësimi në afatmesëm (6-9 muaj pas diplomimit) megjithëse në nivele më të ulëta është më karakteristik në Rajonin Juglindor dhe Jugperëndimor. Lidhur me vetëpunësimin në Rajonin Juglindor dhe Verior të diplomuarit kanë trendin të kontribuojnë në bizneset e familjes duke u vetëpunësuar aty, dhe vetëm 15% e të diplomuarve janë më të predispozuar të hapnin biznesin e tyre para diplomimit. Në Rajonin Jugperëndimor të vetëpunësuarit janë më shumë të prirur të punësojnë nga 1 deri në 3 persona, ndërsa në Rajonin Qendror të vetëpunësuarit prireshin të punësonin më shumë se 3 persona në biznesin e tyre. Vlen për tu theksuar se mënyrat joformale të gjetjes së një pune ishin të përhapura tek të katër rajonet, por tashmë me një peshë mjaft të reduktuar në krahasim me vitin 2021 (kur zinte 80%). Dy mënyrat e tjera më të përdorura ishin nëpërmjet përgjigjes së lajmërimeve të publikuara dhe nga praktika profesionale në biznes.

Lidhur me perceptimin e përgjithshëm mbi sigurinë dhe stabilitetin në punë, në pjesën më të madhe ishte klasifikuar 'i sigurt' dhe 'shumë i sigurt' (shpërhapje që qëndron në të katër rajonet), në ndryshim nga një vit më parë kur për më shumë se gjysmën e të diplomuarve ishte 'neutral'. Perceptimet e sigurisë dhe stabilitetit më të lartë në punë ishin më të theksuara tek të diplomuarit e punësuar të Rajonit Verior dhe Qendror (rreth gjysma e tyre shprehen kështu). Ndarja gjinore tregoi megjithatë se, më shumë meshkuj se femra ndihen të sigurt dhe shumë të sigurt në punën e tyre aktuale. Për sa i përket sigurisë në punë sipas drejtimit, të diplomuarit e punësuar që kishin mbaruar Ekonomi-Biznes dhe Hoteleri-Turizëm ishin më të prirur për t'u ndjerë të sigurt dhe të stabilizuar në vendin e tyre të punës, por përqindjet janë mjaft të larta edhe për degët e tjera (rreth 80%). Në tablonë e perspektivës së vetë-punësimit, më shumë se gjysma e të diplomuarve e shihnin sipërmarrjen e tyre si një aktivitet të përhershëm,

sidomos të diplomuarit në Rajonin Qendror, ndërsa më shumë të diplomuar se një vit më parë ishin më të prirur të shikonin perspektivën e vetëpunësimit si një zgjedhje të përkohshme deri në një punësim më të sigurt në një kompani, me përqindje më të lartë në Rajonin Jugperëndimor.

Për sa i përket nivelit të të ardhurave, prirja që i përkiste pagave për të katërta rajonet ishte niveli 40.001-50.000 lekë, e më i theksuari ndër to shfaqet në Rajonin Juglindor. Rajoni Verior shfaq përqindjen më të lartë në fashën më të ulët të pagave (deri në 40.000 lekë), ndërsa në Rajonin Qendror ka më shumë të diplomuar të punësuar me pagë rreth nivelit mesatar të vendit (fasha 60.001-95.000 lekë). Edhe pse me përqindje të ulëta, Rajoni Verior dhe ai Jugperëndimor kanë më shumë të diplomuar të punësuar me nivele pagash të larta (mbi 120.000 lekë). Ndarja gjinore tregoi se të punësuarat femrat paguhen më pak se të punësuarit meshkujt duke konfirmuar fenomenin e hendekut të theksuar gjinor të pagave në vend. Për të diplomuarit në drejtimet Ekonomi-Biznes dhe Elektroteknikë prirja tentonte për të pasur të ardhura në intervalet me paga më të larta. Krahاسimi i të dhënave tregon se të diplomuarit e punësuar në vitin 2022 paguhen me paga më të larta se kohorta e një viti më parë, ku gjithashtu të punësuarat femra fitonin më pak se të punësuarit meshkujt. Krahاسimi i të dhënave shpërfaq një rënie drastike të të diplomuarve në vitin 2022 që paguhen me pagë minimale krahasuar me kohortën e vitit 2021, por ky ndryshim është mjaft i ndikuar nga rritja e pagës minimale në vitin 2021. Gjithashtu, krahاسimi i të dhënave tregon një rritje të konsiderueshme (më shumë se dyfishuar) të të diplomuarve të cilët paguhen në nivelet e pagave mbi 60.000 lekë.

Për nga relevanca e fushës së studimit me punën, në Rajonin Juglindor të diplomuarit ishin më të prirur të punësoheshin në një punë që lidhej me fushën e tyre të studimit (72%). Edhe përqindja e të diplomuarve që priren të vetëpunësohen në një aktivitet që lidhet me arsimin e tyre është e lartë dhe e ngjashme për të gjitha rajonet (mesatarisht 64%). Për më tepër, më shumë se gjysma e të diplomuarve të punësuar shprehen se i përdornin njohuritë e fituara gjatë studimeve në një shkallë 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë' në punën aktuale, sidomos në Rajonin Juglindor dhe Perëndimor. Rajoni Qendror karakterizohet nga një raport më i lartë i të diplomuarve që vazhdojnë universitetin (95%), ndërsa ai Verior karakterizohet nga më shumë të diplomuar që vazhdojnë formimin profesional krahasuar me rajonet e tjera (8.8%). Tendencia sipas gjinisë për vazhdimin e studimeve në universitet ishte më e theksuar tek meshkujt, ndërsa femrat ishin më të prirura për zhvillim të vazhduar profesional perkundrejt meshkujve. Në Rajonin Jugperëndimor të diplomuarit janë më të prirur për të vazhduar arsimimin, kualifikime apo trajnime të mëtejshme të lidhura me studimet e mëparshme (83.3%). Kualifikimi më i lartë është arsyeja kryesore që i shtyn të diplomuarit të zgjedhin studime të mëtejshme (55.7%) për të katërta rajonet, por më e theksuar është për Rajonin Jugperëndimor (me rreth 65% të të diplomuarve). Meshkujt perkundrejt femrave synojnë një kualifikim më të lartë, ndërsa femrat synojnë që të ndjekin një karrierë tjetër profesionale ose të rrisin mundësitë e punësimit në një punë më të mirë nëpërmjet studimeve të mëtejshme.

Analiza e të dhënave për të diplomuarit që nuk janë punësuar pasqyron që pothuajse një e katërta e të diplomuarve të papunë ishin duke kërkuar aktivisht për një punë. Rajoni Juglindor ka përqindjen më të lartë të të papunëve në kërkim të një pune krahasuar me rajonet e tjera (43%). Gjithashtu trendi i mënyrave për të kërkuar një punë për të katërta rajonet janë njohjet familjare dhe miqësore (50%) dhe parashtrimi i kërkesave nëpërmjet zyrave të punës. Megjithatë, mënyra e kërkimit nëpërmjet ZP është më përfaqësuese në Rajonin Verior dhe Juglindor. Arsyeja kryesore që të diplomuarit e papunë nuk kanë kërkuar për një punë gjatë 4 javëve të fundit para pyetësorit ishin planet për t'u larguar nga vendi (rreth 40%), dhe kjo ishte më e theksuar për Rajonin

Verior. Nuk ka dallime gjinore përsa i përket synimit për të emigruar në dallim nga një vit më parë kur ky fenomen ishte dominues për meshkujt.

Konkluzioni mbi analizën e vlerësimit retrospektiv tregon se pjesa më e madhe e të diplomuarve do rizgjidhnin përsëri të njëjtën shkollë nëse do paraqitej mundësa, dhe ky koncept në krahasim me kohortën e të diplomuarve të një viti më parë ishte mjaft më i lartë. Gjithashtu mund të thuhet se ky perceptim nuk shfaq dallime të theksuara bazuar në gjini. Aftësitë teorike dhe praktike të stafit mësimdhënës dhe metodat e mësimdhënies kanë përqindjen më të lartë të vlerësimit, ku 86.4% dhe 83.7% e të diplomuarveshprehense vlerësojnë 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' këto aspekte. Infrastruktura është gjithashtu një aspekt që vlerësohet nga më shumë se 80% e të diplomuarve me kategorinë 'shumë/jashtëzakonisht shumë', ndjekur nga praktikatat në shkollë dhe në biznese të cilat vlerësohen me kategoritë 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë' nga respektivisht 79.4% dhe 76.9% e të diplomuarve. Bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës perceptohet si aspekti me vlerësimin më të ulët (19.0%). Dy aspektet e tjera të kategorizuara me vlerësimin më të ulët janë këshillimi i karrierës (14.8%), dhe bashkëpunimi i shkollës me bizneset (13.2%), ndjekur nga praktika në biznes dhe praktika në shkollë (me 8.6% dhe 7.5% përkatësisht). Nuk ka dallime të rëndësishme gjinore lidhur me vlerësimin e aspekteve të shkollës me kategorinë më të lartë të vlerësimit 'shumë dhe jashtëzakonisht shumë', por janë përgjithësisht femrat që shfaqin përqindje pak më të larta se meshkujt, përveç aspektit të bashkëpunimit të shkollës me bizneset, ku vetëm 14.3% e femrave japin vlerësimin më të lartë kundrejt 67.5% të meshkujve.

Përsa i përket pritshmërive të të diplomuarve për 2 vitet e ardhshme, rreth 50% e tyre planifikonin të gjenin një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, apo dëshironin të kishin filluar një biznes të tyre. Vihet re një rritje e konsiderueshme e të diplomuarve që dëshironin të ndiqnin studime të mëtejshme (dyfishuar nga në vit më parë) dhe ulje të dëshirës për migrim në një qytet tjetër. Një përqindje më e madhe e të diplomuarve në Rajonin Qendror dhe Verior aspiron për të vijuar studime të mëtejshme krahasuar me rajonet e tjera. Femrat, më shumë se meshkujt synojnë të kenë gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të studimit dhe të ndjekin studime të mëtejshme, duke nënvizuar rëndësinë praktike të studimeve për femrat. Ndërsa të diplomuarit meshkuj aspirojnë më shumë për të filluar një biznes të tyre dhe për të emigruar krahasimisht me femrat.

Rekomandimet të bazuara në analizën e përgjithshme të të dhënave të kryera nga gjurmimi në nivel kombëtar vijnë si më poshtë:

- Vijimi i monitorimit dhe analizimit të punësimit të të diplomuarve në sektorë të rëndësishëm për ekonominë e vendit, duke stimuluar rritjen e punësimit në rajonet që kanë tranzicion më të ngadaltë drejt tregut të punës dhe kanë më shumë të diplomuar që fillojnë biznes në afatmesëm apo afatgjatë.
- Stimulimi i mënyrave formale të kërkimit për punë kundrejt njohjeve dhe lidhjeve familjare, duke shtuar ose ndërmjetësuar gjetjen e një pune, sidomos nëpërmjet praktikës në biznes.
- Fuqizimi i mëtejshëm i ndërlidhjes me Zyrat e Punës, duke përfshirë edhe udhëzime mbi proceset dhe funksionimin e shërbimeve sidomos për vajzat. Zyrat e Punës të zgjerojnë gamën e aktivitetit të tyre në funksion jo vetëm të sugjerimit të vendeve vakante dhe programeve kombëtare të punësimit, por dhe këshillimit sesi të kërkohet një punë (sidomos në Rajonin Jugperëndimor dhe për gjininë e femrave).

- Forcimi i rolit të shkollave të arsimit profesional në ndihmën e dhënë kundrejt nxënësve, si në këshillim mbi aplikimin e një vendi pune, këshillim i karrierës, ndihma për vendosjen e kontakteve me punëdhënësit potencialë, duke vijuar në shpjegimin e rolit të zyrave të punës dhe fuqizimin e besimit dhe interesit në shërbimet funksionale të tyre në procesin e punësimit.
- Përmirësime të orientuara drejt aspekteve si bashkëpunimi i shkollës me bizneset, këshillimi i karrierës, dhe sidomos bashkëpunimi i shkollës me zyrat e punës, për të cilat vlerësimi i të diplomuarve ka qënë më i ulët krahasuar me aspektet e tjera.

